

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
 Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
 Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7372 E diel 3 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** **Ditës**
 Varfëria në Shqipëri ka karakter shumëdimensional e tashmë të tejskajshëm. Po t'i referohemi shifrave statistikore, gjatë vitit 2016 në Shqipëri ...
 Vijnë në faqen 21

Nga ROVENA HOXHA
 Varfëria, si forma më e hapur e dhunës ndaj popullit



Opinion **i** **Ditës**
 K a më shumë se 4 vjet që ekipi i "Rilindjes" apo i Edi Ramës mburret se ka marrë përsipër t'u realizojë shqiptarëve atë që u ka munguar gjatë më shumë se një ...
 Vijnë në faqen 22

Nga XHEVAT MUSTAFA
 Shteti pa mirëqenie, aspak ai "që duam"



Ja udhëzimi i Institutit të Sigurimeve
Pensioni social, 5 kushtet për ta përfituar dhe dokumentet

Çdo person duhet të paraqesë një herë në vit deklaratën për gjendjen ekonomike
 Nga ORNELA MANJANI
 Instituti i Sigurimeve Shoqërore publikon kriteret e përfitimit të pensionit social. Për t'u përshirë në skemën e përfitimit personat duhet të jenë mbi moshën 70 vjeç, të qëndrojnë në Shqipëri, të paktën për 5 vitet e fundit, nuk ...
 Në faqen 8

RAPORTI/ POLITIKA PENALE: ZBUTJE DENIMESH NE 10 VITET E FUNDIT "HARTA" E FAMILJEVE KRIMINALE NE SHQIPERI

Fondacioni "Shoqëria e Hapur": Organizatat kriminale investuan në biznese të ligjshme. 3 organizata kriminale në Tiranë, 1 në Durrës, 1 në Fier



(Në foto) Harta e grupeve kriminale në Shqipëri
 Në faqen 11

INTERVISTA
Vasilika Hysi:
 Reforma në drejtësi, ishte si një universitet i dytë
 Në faqen 6-7

SHTOHEM KONTROLLET
Tatimet: Nisin gjambat në janar, përfitoni nga amnistia
 Në faqen 9

DEMET PAS SHIUT
Basha: Duhet ndërhyrje urgjente nga qeveria
 Në faqen 5

MONUMENTET
Përmblytjet, uji nxirret me pompë nga kishat e Voskopojës
 Në faqen 12

DOKUMENTI I 1990
EKSKLUZIVE
Martin Camaj: Pse nuk pëlqehet letërsia ime në Shqipëri?
 Suplement

Rama ia vë fajin qeverisë teknike: Përmblytjet, faji edhe i zjarreve të verës
Reshjet, 3250 shtëpi dhe biznese nën ujë
 Moti i keq, presidenti Meta inspekton situatën në Fier dhe Berat

Nga DARINA TANUSHI
 Kryeministri Edi Rama inspektoi dje, zonat e përmblytura në jug të vendit, duke e nisur nga Fieri e më pas në Vlorë, shoqëruar nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka e deputetët e zonave. Në takimin e fundit që pati



në Vlorë, Rama tha se dëmet e shkaktuar erdhën edhe si pasojë e zjarreve që ranë gjatë verës. "Ne kemi filluar që tani të marrim masa për verën e ardhshme, do shtrëngojmë shumë fort edhe legjislacionin dhe nuk do falim askënd që do luajë me këtë pasuri...
 Në faqen 4

PERMBYTJET DEMET

Fushë-Kruja në gjendje "lufte". Ish-polici: As në 97-ën s'e kemi parë veten më keq

Çahet argjinatura, fshatrat e Fierit dhe Vlorës nën "thundrën" e lumit Vjosa

Situatë e rënduar në Shijak e Sukth të Durrësit

Përmbytjet e shkaktuara nga rrebeshi e shirave dhe dalja nga shtrati i lumenjve ka dëmtuar më së shumti Vlorën, Fierin dhe Krujën. Niveli i ujit në banesat e disa fshatrave në Vlorë dhe Fier ka arritur deri në 1 m, ndërsa në Mallkuç të Fushë-Krujës ka vijuar dhe gjatë ditës së djeshme evakuimi i banorëve. Mungesë energjie, segmente rrugore të bllokuara, diku nga përmbytjet, në vende të tjera nga rrëshqitja e dherave dhe gurëve. Në këtë situatë janë zgjuar dhe shumica e zonave në jug të vendit, ndërsa në veri kanë rinisur reshjet e borës. Ndërkëq, mësohet se si pasojë e daljes nga shtrati të lumenjve Shkumbin e Devoll, ka pasur probleme edhe në Elbasan, ku është përmblytur nënstationi në Zëmbllak, duke lënë kështu pa energji zona të tëra. Pavarësisht rënies së intensitetit të reshjeve, situata vijon të jetë e rënduar dhe në Shijak të Durrësit, ku janë përmblytur 80 banesa dhe janë evakuuar 50 familje.

VLOORË

Ndonëse intensiteti i reshjeve që përfshiu vendin tonë, ishte më i ulët, uji ka vërshuar në orët e para të mëngjesit të djeshëm nëpër shtëpi, në fshatrat: Novoselë, Vitore, Mifol, Ferras e Bishan, si pasojë e çarjes së argjinaturave të lumit Vjosë. Në ndihmë të qytetarëve kanë shkuar Forcat e Armatosura, të cilët kanë evakuuar 20 banorë nga shtëpitë e tyre në fshatin Ferras. Pas një mbledhje të Shtabit të Emergjencës në Novoselë, ku mori pjesë edhe ministri Damian Gjiknuri, u mor vendimi që banorët, shtëpitë e të cilëve janë pranë lumit, të evakuohej për të shmangur ndonjë rrezik të pamenduar. Pallati i Sportit të Vlorës u pajis me shtretër ku mund të zhvendoseshin njerëzit në nevojë. Mësohet se në 80 banesa ka depërtuar uji. Rrjedha e krijuar në



Përmbytjet nga Vjosa

FIER/ TRE POLICËT

Vërshimi i lumit Vjosë ka rrezikuar jetën e tre punonjësve të policisë në Fier. Mbrëmjen e së premtes, një mjet i shërbimit të patrullës së përgjithshme është bllokuar në segmentin "Kthesa e Qarrit" - "Ura e Mifolit", aty ku niveli i ujit arrin në 1 m lartësi, duke rrezikuar edhe jetën e tre punonjësve të policisë. FA, të cilët kanë bërë të mundur shpëtimin e tre efektivëve.



VLOORË/ E MOSHUARA

Policia e Vlorës ka ndihmuar dhe shpëtuar një 70-vjeçare, e cila kishte mbetur e bllokuar në banesën e saj prej daljes së lumit Vjosë. E moshuara banonte krejt e vetme në Mifol të Novoselës, ndërsa një ekip me katër policë i kanë ardhur në ndihmë, duke e zbritur me shkallë nga ballkoni i katit të dytë.



SARANDE

Fryrja e shtratit të Përroit të Gurrës, në Vergo ka sjellë shumë probleme për zonën, veçanërisht në furnizimin me energji elektrike. Sipas OSHEE-së, përroi ka marrë me vete 7 shtylla së bashku me linjën elektrike. Për emergjencë është vendosur një linjë për të furnizuar me energji fshatrat Fushë-Vërrë, Kalasë e Tatzat.

URA E ZËMBLAKUT

Ura e Zëmbllakut në fshatin Menkulas të Korçës rrezikon të shembet për shkak të reshjeve të shumta. Mësohet se ura ka pësuar deformim dhe për të shmangur rrezikun për jetët e njerëzve, qarkullimi është devijuar në rrugën dytësore. Sipas burimeve nga policia e qytetit juglindor, nuk lejohet kalimi i mjeteve të tonazhit të lehtë dhe të rëndë.



Pamje nga përmbytjet e djeshme

VDEKJA E ELEKTRICISTIT

Vdekja e një elektrikisti në krye të detyrës ka vënë në lëvizje policinë e Fierit, e cila ka ndaluar dy kolegë të viktimës, të cilët akuzohen për "Shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë". Ata janë Tafil Çepele, 63 vjeç, banues në Kuman dhe Tajar Zhupani, 63 vjeç, banues në Marinëz, Roskovec. Ndalimi i këtyre shtetasve u bë pasi në datën 30.11.2017, në fshatin Kurjan dhe konkretisht në linjën e fidrit nr. 2 Drizë, gjatë kryerjes së punimeve, është goditur nga tensioni i lartë dhe për pasojë ka gjetur vdekjen elektrikisti, shtetasi S.V..

Përmbytjet në autostradë, Petro Koçi: Duhet parë pjesa e ndërtimeve dhe kanalet kulluese

TIRANË - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, ka komentuar situatën me përmbytjet e dy ditëve të fundit në vendin tonë. Duke u ndalur të rasti i regjistruar në hyrje të autostradës Tiranë-Durrës, ku disa automjete mbetën të bllokuara për shkak të nivelit të lartë të ujit, Koçi tha se në këtë situatë ndikojnë edhe faktorë të tjerë. Në emisionin "Kjo Javë" në "News24", zëvendësministri deklaroi se duhet riparë "pjesa e ndërtimeve pranë autostradës, po kështu edhe rrjeti i kanaleve kulluese". Ai shtoi se, "megjithatë duhet të themi se niveli i reshjeve ka qenë i lartë. Janë sasi të mëdha reshjesh".



rrugën lidhëse mes fshatit Novoselë, Fitore, Bishan etj., pra 6 fshatra, janë të pakalueshme.

FIER

Pas daljes së lumit Vjosa nga shtrati, situata në Fier paraqitet problematike. Për shkak të vërshimit të ujërave të lumit Vjosa, është përmblytur nga uji aksi rrugor Levant-Tepelenë. Katër persona janë bërë apel për ndihmë, pasi u bllokuan brenda mak-

inës në fshatin Ferras të Fierit. Sakaq, burime nga prefektura e Fierit bën me dije se deri në orën 13:00 të ditës së djeshme janë përmblytur 333 banesa, ndërsa rrezikohen 250 të tjera në të gjithë qarkun. Po sipas këtyre burimeve janë evakuuar 70 familje nga Emergjencat Civile, ndërsa dy persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Gjithashtu, në qarkun e Fierit janë përmblytur 3500 ha

tokë, ndërsa rrezikohen 5000 ha të tjerë në orët në vijim, nëse situata do të agravohet.

DURRËS/ FUSHË-KRUJË

Moti i keq ka krijuar situatë "lufte" në Fushë-Krujë, pasi çdo mobilie apo automjet i banorëve është shkatërruar. Një prej banorëve të Fushë-Krujës (ish-efektiv policie në Shkodër) u shpreh se "Jam i zhgënjyer, pasi kam pësuar shumë dëme

materiale. Dy herë brenda vitit u përmbytëm, edhe në vitin 97" kur kam filluar punë me plumbave s'kam qenë më keq. Më është shkatërruar çdo gjë. 15 mln lekë dëm tani, 15 mln dëm herën e parë, plot 30 mln lekë kam humbur"-u shpreh ai.

DURRËS/ SHIJAK

Dalja e lumit Erzen nga shtrati ka shkaktuar dëme në shumë banesa në Shijak, Sukth, Katund të Ri, Flakë e

fshatra të tjera. Nga përmbytjet janë shembur 3 ura në Shijak, duke bllokuar qindra banorë të fshatrave: Gje-palaj, Çizmel dhe Shetel. Ndërsa probleme ka edhe në Ballias, pasi janë bllokuar rrugët. Mësohet se nga reshjet janë përmblytur 80 banesa dhe janë evakuuar 50 familje. Bashkia ka shpërndarë grupet e punës në terren për të bërë vlerësimin e dëmeve.



TIRANË - Ndërprerja e reshjeve të shiut si dhe puna e kryer nga specialistët e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve të Tiranës përgjatë 24 orëve, ka bërë që situata në liqenin e Bovillës të përmirësohet ndjeshëm dhe të rinisë furnizimi me ujë i disa lagjeve të kryeqytetit, të cilat dy ditë më parë, për shkak të turbullimit të ujëmbledhësit, patën ndërprerje të ujit. Dje, kryebashkiaku Erion Veliaj inspektoi në terren situatën në impiantin e Bovillës, ndërsa bëri të ditur se ka rinisur furnizimi me ujë për zonat që patën probleme gjatë 24 orëve të fundit. "Falë punës së kolegëve, edhe ndihmës që patëm nga kushtet atmosferike ka dekantuar një pjesë e madhe e turbullirës dhe jemi në një situatë ku praktikisht ky

"Shmangëm një epidemi ose bllokimin total të filtrimit të ujit"

Rivihet në punë impianti i Bovillës, kreu i Bashkisë, Erion Veliaj: Nuk janë hapur portat



Kryebashkiaku Erion Veliaj dje në impiantin e Bovillës

është uji që hyn në Bovillë dhe ky është uji që del nga Bovilla dhe që sot ka cilësinë optimale, që uji ka çdo ditë në Tiranë", pohoi Veliaj. Ndërkaq, ai bëri të ditur se mbyllja e Bovillës ishte e pamëshmangshme për shkak të

nivelit të lartë të turbullirës së ujit, si pasojë e prurjeve të mëdha të shiut. "Me rritjen e turbullirave jemi të detyruar që të mbylлим impiantin, sepse nuk mund të çojmë ujë, që ka qenë disa herë më keq se sa cilësia që

NDIHMAT

Paralelisht me punën në terren të ndërmarrjeve të Bashkisë së Tiranës për rehabilitimin e zonave të prekura nga përmbytjet, rrjeti i vullnetarëve ka ndihmuar gjatë gjithë natës, duke përgatitur pakot me ushqime dhe veshje që do t'iu shpërdahen familjeve në nevojë.

ju shikoni në epruvetë. Në momentin që kemi pasur ujin nga një normë 50 në normën 13.000 NTU, pra 260 herë më shumë se çfarë duhet të jetë norma, sigurisht që do të shkaktonim ose një epidemi në Tiranë ose një

bllokim total të filtrimit të ujit, që do të bënte që të çonim në një remont disa ditor, disa javor ndoshta, gjithë sistemin e filtrimit në Bovillë", tha kreu i Bashkisë. Veliaj hodhi poshtë të gjitha keqinformimet e bëra gjatë së premtes, duke theksuar se portat e ujëmbledhësit të Bovillës nuk janë hapur për asnjë moment, pasi shkarkimi i ujit nuk ka qenë i nevojshëm për faktin se ende edhe sot (dje) niveli i liqenit mbetet shumë poshtë nivelit maksimal të lejueshëm. Ndërkaq, mësohet se paralelisht me punën në terren të ndërmarrjeve të Bashkisë së Tiranës për rehabilitimin e zonave të prekura nga përmbytjet, rrjeti i vullnetarëve ka ndihmuar gjatë gjithë natës duke përgatitur pakot me ushqime dhe veshje që do t'iu shpërdahen familjeve në nevojë.

Komiteti i EC: U dëmtuan 40 biznese dhe 49 shkolla. IGJEUM: Mbetet problem, Vlora e Fieri nga lumi Vjosa

Moti i keq, 3233 banesa e biznese të përmbytura

Mbi 7800 ha tokë janë zhytur nën ujë, u evakuuan 1594 persona

TIRANË

Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave pranë kryeministrit bëri dje me dije dëmet e shkaktuara nga moti i keq në të gjithë vendin tonë. Në njoftimin për mediat citohet se pavarësisht se intensiteti i reshjeve po bie, rreziku kryesor paraqitet në pellgun e lumit Vjosë, sidomos në Vlorë dhe Fier. Në mbledhjen e këtij komiteti ku morën pjesë ministri dhe kryeministri Edi Rama u dhanë shifrat në lidhje me situatën e përmbytjeve. Sandër Lleshi, këshilltar i kryeministrit Rama për sigurinë, bëri një përmbledhje të situatës. Ai tha se ka rreth 3193 banesa të përmbytura, 40 biznese, 7874 ha tokë e përmbytur si dhe 1594 persona të evakuuar. Sipas Lleshit tani prurjet janë 2200 metër kub për sekondë në Vjosë. Në zonën e përmbytjeve dhe problematikës i është shtuar Korça dhe Përmeti. Ndërkaq, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), në buletinin e fundit për rreziqet që e presin vendin, raportoi të dhëna alarmante për situatën, me të cilën pritet të përballet kryesisht pjesa jugore e Shqipërisë. "Mbeten aktive paralajmërimet për vazhdimin e përmbytjes nga Lumi Vjosa në qarqet Fier dhe Vlorë. Nga llogaritjet e fundit hidrologjike rezulton se,



Sandër Lleshi, këshilltar i kryeministrit për sigurinë

në pjesët fushore të këtyre lumenjve do të vazhdojë përmbytja me prurje shumë të larta nga Lumi Vjosa. Efektet kryesore të përmbytjeve në pjesët fushore në qarqet Vlorë dhe Fier do të vazhdojnë përgjatë ditës së shtunë", thuhet në buletinin e IGJEUM. **DËMET NGA PËRMBYTJET** Sipas Komitetit të Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, Fierza

është nën nivelin kritik, por afër. "Komani dhe Vau Dejës janë në këtë nivel dhe po bëjnë shkarkime. Kemi rreth 507 familje të evakuara, 1594 persona të evakuuar, tërheqje e njerëzve në rreziq për jetën. Ka pasur dhjetëra episode gjatë natës duke shpëtuar njerëz në kushte ekstreme. Rrugët kryesisht të lira. Arteriet kryesore funksionale. Energjia elektrike ka kaluar në zonën e verdhë, afër nor-



Harta e përmbytjeve nga IGJEUM

HARTA E RE E IGJEUM

Shenjat e alarmit për përmbytje urbane ose nga përrënjtë dhe lumenjtë e vegjël janë hequr nga tabela e qarqeve, sepse këto përmbytje e kanë kaluar pikën kritike. Mbeten aktive paralajmërimet për vazhdimin e përmbytjes nga lumi Vjosa në qarqet Fier dhe Vlorë. Nga llogaritjet e fundit hidrologjike rezulton se, në pjesët fushore të këtyre lumenjve do të vazhdojë përmbytja me prurje shumë të larta nga lumi Vjosa.

malitetit. Ka pasur disa probleme tek ujësjellësit, tek i Bovillës, Krutës. Ka rreth 3193 banesa të përmbytura, 40 biznese, 7874 ha tokë e përmbytur. Shkolla të dëmtuara 49. Masat e marra në përgjithësi: janë shtuar kapacitetet dhe operacionet në kërkim shpëtimi dhe evakuim. Janë 34 forca nga Kosova në Fier. Sot (dje) kanë filluar edhe operacionet e rikuperimit, në rrethin e Krutës dhe Tiranës. Ka filluar dhënia e ndihmave. Ka filluar pastrimi dhe rikthi-

mi në normalitet edhe në jug. Janë shtuar zërat ndërkombëtarë për të dhënë ndihmë. 6406 forca të përfshira, 1081 mjete. Jemi në fazën e dytë të procesit, të reagimit. Do të fillojë shpejt likuidimi i pasojave për të kaluar te faza e fundit, për zgjidhjen. Sot (dje) jemi në përfundim të fazës së dytë, që është reagimi emergjent", bëri të ditur këshilltari i kryeministrit Rama. Ndërsa, drejtori i Emergjencave Civile, Shemsi Prençi tha se janë dëmtu-

ar në të gjithë vendin 13 ura dhe theksoi se prurjet e Vjosës janë më masive se në vitin 2015. "E veçanta e kësaj situatë është se kemi pasur një parashikim të saktë meteorologjik. Janë dëmtuar 13 ura në të gjithë territorin e RSH. Përmbytjet janë shtirë kryesisht në Krutë, Durrës, Shijak, Sukth, Frakull, Levan që janë problematike për shkak të kapërcimit të arginatës, jo shkatërrim të arginatës si rezultat i prurjeve më masive se në 2015", tha Prençi.

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE TIRANË

Zyra e Përmbartimit Tirane me përmbareus gjyqësor Albert Fejzo, në baze të vendimit nr. 10484, date 30.11.2017, shpall shpëtim në ankim të pasurisë apartamentin të banimit me sipërfaqe 57 m2 të ndodhur në Rrugën: "Irfan Tomini", pallati 10/2/60 në Zonën kadastrale 8260 të regjistruar Zyra Vendore Regjistrimit Pasurisë Pallaqshme Tirane me nr pasurie nr 254+4-60, volumni 6, faqe 82 Tirane, në vlerën duke filluar nga 2.800.000 (dy milion e tetëqind mijë) Lekë.

Ankandi zhvillohet me ambientet e Zyres të Përmbartimit Tirane, në adresën: Sheshi Mustafa Ataturk, Kryeqezimi "21 Dhjetori", Tirane ditën e Premte, me date 15.12.2017, ora 16.00.

PERMBYTJET POLITIKA

Kryeministri e ministrja e Mbrojtjes vizitojnë zonat e përmbytura në Fier e Vlorë

Rama: Përmbytjet, edhe nga zjarret e verës, përfituan nga qeveria teknike

"Do shtrëngojmë ligjet, nuk do falim askënd që luan me pasurinë"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama inspektoi dje, zonat e përmbytura në jug të vendit, duke e nisur nga Fieri e më pas në Vlorë, shoqëruar nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka e deputetët e zonave. Në takimin e fundit që pati në Vlorë, Rama tha se dëmet e shkakuar erdhën edhe si pasojë e zjarreve që ranë gjatë verës. "Ne kemi filluar që tani të marrim masa për verën e ardhshme, do shtrëngojmë shumë fort edhe legjislacionin dhe nuk do falim askënd që do luaj me këtë pasuri, sepse përfituan nga qeveria teknike vjet", -u shpreh Rama. Duke u ndalur në zonat kritike të Fierit, pas një nate të rënduar nga reshjet e prurjet e lumit, kryeministri pa nga afër problematikën e krijuar pas vërshimit të ujërave. "Është pozitive kësaj radhe, që s'kemi asnjë humbje në gjënë e gjallë të raportuar nga fermerët në gjithë këto zona", - u shpreh kryetari i Bashkisë, Armando Subashi. Kryeministri vlerësoi maksimalisht angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjithë strukturave operacionale në vend, për të përballuar këtë fatkeqësi, e cila, pavarësisht se ishte më e rëndë se ajo e 2015, solli më pak dëme për shkak të masave të marra paraprakisht nga gjithë strukturat e përballimit të situatave të tilla. "Ishte shumë e frikshme situata, sepse faktikisht tejkaloi 2015-n në mënyrë shumë tej parashikimit dhe ishte një sprovë e madhe për të gjithë ndërhyrjet që kemi bërë, por që treguan dobishmërinë e tyre. Tani, duke u nisur nga pikat e dobëta të kësaj situatave, duhet që të vazhdojmë ndërhyrjet aty ku faktikisht identifikohet domosdoshmëria për krijimin e infrastrukturës së sigurisë dhe të mbrojtjes, në mënyrë që të kemi shumë më tepër imunitet kur të vijë tetra, se tani këto janë bërë ciklike për shkak edhe të gjithë ndryshimeve të klimës", - u shpreh kryeministri. Më tej, në Novoselë, kryeministri u përshëndet me ushtarakët e përfshirë në këto operacione,



Kryeministri Edi Rama dje në Fier

duke i falënderuar për përkushtimin e lartë profesional e njerëzor; duke qenë në vijën e parë të përpjekjeve për përballimin e situatës dhe shpëtimin e jetës njerëzore. "Kemi bërë një punë shumë fantastike. Të gjithë e kanë parë dhe e gjithë Shqipëria ua di për nder. Jam shumë krenar për ju." Rama u ndal edhe në Pallatin e Sportit në qytetin e Vlorës, ku ishte ngritur qendra për të pritur qytetarë, shtëpitë e të cilëve mund të rrezikohen nga përmbytjet.

Kryeministri Rama, i shoqëruar nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, kryetari i Bashkisë Dritan Leli tha se, "Ajo që është më e rëndësishme, është që jo vetëm asnjë jetë njeriu, por nuk ka asnjë kokë bagëti të humbur, as në Vlorë, as në Fier, asgjëkund, si pasojë e organizimit që bëmë prej javësh me forcat e armatosura, me policinë, me emergjencat, me grupe të pesëfishuara forcash në krahasim me 2015, për ta përballuar situatën."



Lu e Xhaçka në sallën operative të FA: Solidaritet për kapërcimin e situatës

Ambasadori amerikan, Donald Lu vlerësoi dje, punën e Forcave të Armatosura. Këtë diplomati amerikan e tha gjatë një takimi me ministrin e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, teksa vizituan sallën operative në Qendrën e Bashkuar Operacionale të Forcave të Armatosura, ku u njohën me situatën aktuale pas përkëqesimit të motit në vend. "Ambasadori amerikan vlerësoi punën dhe angazhimin e deritanishëm të FA dhe shprehu solidaritet dhe mbështetje për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FA për kapërcimin me sukses të situatës së ditëve të fundit", -thuhet në njoftimin për mediat të Ministrisë së Mbrojtjes. "Salla operative në QBO funksionon me shërbim 24/24 dhe koordinon të gjitha angazhimet e FA në terren në situata emergjencash. Gjatë natës puna për menaxhimin e situatës në këtë sallë u ndoq nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka. Aktualisht FA kanë të angazhuar në terren 450 efektive për evakuimin e banorëve dhe ndërhyrjen në argjanturat e lumenjve", - bëri me dije dje, ministria e Mbrojtjes.



Meta viziton

zonat e përmbytura, shpreh mirënjohje për ekipet e shpëtimit

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ishte dje, në mbërmje në fshatin Ferras, të Fierit ku u takua me Forcat e Armatosura, ato të policisë dhe ekipet e emergjencave të Kosovës. Kreu i shtetit tha se është "kënaqësi të falënderoja sot në Ferras Forcat e Armatosura, ato të Policisë dhe ekipet e emergjencave të Kosovës për menaxhimin plot përkushtim të përmbytjeve të Vjosës në ndihmë të banorëve të rrezikuar". "Mirënjohje për sakrificat e tyre, sepse jeta e qytetarëve është e para", -tha kreu i shtetit Ilir Meta, në një postim në "FB". Ndërkohë më herët ai ka pasur një bisedë me Presidentin kosovar Hashim Thaçi. Ishte Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi që i telefonoi dje, Presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta. "Në emër të institucioneve të Kosovës, shpreha gatishmërinë që ta dërgojmë Forcën e Sigurisë për t'indihmuar ekipet e tyre në menaxhimin e krizave dhe emergjencave civile. Jemi të shqetësuar për vëllezërit e motrat tona atje dhe urojmë që situata të mos përkëqesohet më shumë", -njoftoi Thaçi. Pasi pa nga afër situatën e krijuar nga përmbytjet në Qarkun e Fierit, Presidenti i Republikës, Ilir Meta është ndalur në qytetin e Beratit për të inspektuar zonën e përmbytur në pedonale e qytetit dhe u takua me Prefektin e Qarkut Berat, Harilla Dafa, ku u njoh me masat e marra për të përballuar emergjencën. Gjithashtu, Presidenti Meta u takua edhe me banorët e prekur nga përmbytjet që janë strehuar në konviktin e shkollës industriale të Beratit.



Kryemadhi: Qeveria të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme, duhet shpejtësi


Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi i kërkoi dje, Qeverisë të mos humbasë më kohë, por të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme. Në një reagim të saj, Kryemadhi tha dje: "Jemi pranë të gjitha familjeve, të cilat po përballen me një vështirësi të jashtëzakonshme, të diktuar nga kjo fatkeqësi natyrore e rëndë. Solidaritet me të gjithë të prekurit anë e mbanë vendit nga kjo fatkeqësi e dimensioneve shumë të gjera". "Qeveria shqiptare duhet të mos humbasë më kohë, por në respekt të ligjit të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme, të mobilizojë fonde financiare, ndihma ushqimore, logjistike e duhur që situata të kalohet me sa më pak dhimbje për mijëra qytetarët e prekur. Koha nuk pret! Çdo hezitim mund të sjellë pasojë të pakthyeshme në shëndetin e njerëzve, në banesat e tyre, në mijëra biznese që dëmtohen, prandaj duhet vepruar me shpejtësi!", -tha ajo. Ndërsa deputeti Shezai Rrokaj kërkoi dje, nxjerrjen e përgjegjësisë për situatën e krijuar.

Taulant Balla: Saliu dhe Luli në opozitë, fat i mirë për Shqipërinë

Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla, veç ndjekjes së situatës së krijuar nga përmbytjet në qarkun e Elbasanit iu përgjigj akuzave të PD-së për keqmenaxhim të kaskadës së Drinit. "Falë një menaxhimi profesional, u bë e mundur që në vetëm 4 ditë të rritje rezervave energjetike e vendit me 116 Gwh dhe të ngrihej niveli i basenit të HEC Fierzës me rreth 5 metra", -u shpreh Balla. "Mos harroni se kjo formë menaxhimi profesional ka 4 vite që ndodh, pa krijuar asnjë fenomen përmbytjesh në qarket e Shkodrës dhe Lezhës", -u shpreh ai. Duke ironizuar kreun e PD-së, Balla tha se "Ata që dinë se 7 x 7 = 42 apo 36 + 49 = 95, nuk kanë pasur menaxhim tjetër, veçse të hapnin portat e të përmbysnin ç'të dilte përpara! Ai që paguan 1 milion dollarë në dëm të imazhit të Shqipërisë, nuk di të bëjë as një punë". "Saliu dhe Luli në opozitë janë fat i mirë dhe për Shkodrën e Lezhën, e për gjithë Shqipërinë", -tha Balla.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 06.12.2017 në orën 16:00 në zyrën e përbarësut gjyqësor privat Irista Tereziu PF Me adrese ne : Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, njesia Tregtare nr. 10 Tirane, zhvillohet ankandi per shiten e pasurise se paluajtshme te llojit "Njese" me siperfaqe totale 87.2 m2, numer pasurje, 15/231 -N1, vol.2014 -2016, ne zonen kadastrale 8551 me adrese Kavaje. Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 5,830.687.52 (pese milionin e teteqind e tridhete mije e gjashteqind e tetedhete e shtate oke pesedhete e dy Lek)



Kryeministri Edi Rama dhe në zonat e përmbytura në Vlorë

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha i kërkoi dhe kryeministrit Edi Rama të dërgojë ndihmë në Fushë-Krujë. Kreu i PD-së, i rikthye banorëve të dëmtuar nga përmbytjet në zonën e Fushë-Krujës, duke vizituar disa shtëpi. "Në Fushë-Krujë situata kërkon ndërhyrje emergjente nga qeveria. Me qindra banorë të përmbytur në fshatin Hasan nuk kanë ushqim. Të njëjtin problem kishin banorët në Bilaj. Ata ishin 24 orë pa ngrënë, sepse qeveria nuk u ka çuar asnjë ndihmë. I bëj thirrje Edi Ramës të mos e shohë situatën nga asfalti i autostradës, siç më thanë banorët se ka bërë me Fushë-Krujën, por të shkojë pranë njerëzve, t'i ndihmojë me ushqime, me veshje dhe me strehim", u shpreh dhe me vizitën në këtë qytet, Basha. "Në Fushë-Krujë pata rastin të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen për ushtarët dhe policët që po sakrifikojnë prej 3 ditësh për të shpëtuar jetën e njerëzve. Më e keqja akoma nuk ka kaluar. Do jemi në Fier dhe në Vlorë për t'u gjendur pranë qytetarëve të prekur nga përmbytjet", njoftoi ai. Gjatë vizitës që pati në Fushë-Krujë, Basha u njoh me shqetësimet e banorëve. Një prej tyre i tha se nuk u kishte ardhur askush t'i vizitonte. "Të mbarojë kjo

Kryetari i PD-së dhe deputetët shpërndahen në zonat e përmbytura

Basha në Fushë-Krujë: Duhet ndërhyrje urgjente nga qeveria

"Përgjegjësit do të dalin pas fazës së emergjencës"



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha dhe në Fushë-Krujë

gjendje se andej nga jugu është akoma më e vështirë", u përgjigj Basha. Basha ishte brenda në Fushë-Krujë, ku janë përmbytur dy lagje, në fshatin Bilaj dhe në Hasan, ku banorët kanë 24 orë pa ushqime. "Kam ardhur t'ju shoh dhe për të ndërgjegjësuar që t'ju

gjenden pranë e t'ju ndihmojnë. Ju keni nevojë për ndihmë", u tha Basha, banorëve. Banorët në Fushë-Krujë i thanë Lulzim Bashës se mesnatën e së premtës kryeministri qëndroi fare pak minuta në autostradë dhe nuk i takoi të përmbytur. Basha i kërkoi Ramës

FRPD

Kryetari i FRPD, Belind Këllçi, së bashku me kryetarin e Forumit Rinor të Paskuqanit dhe anëtarë të FRPD-së, ishte pranë familjeve të përmbytura në zonën e Babrrusë, Kodër të Kuqe dhe Paskuqan. Të rinjtë demokratë shpërndanë ndihma ushqimore për familjet e prekur nga përmbytjet për t'u ardhur sado pak në ndihmë në këto ditë të vështira.

Pastaj të gjithë përgjegjësit do të mbajnë përgjegjësi", u tha Basha. Ndërkohë edhe deputetët e PD-së janë shpërndarë këtu dy ditë nëpër zonat e tyre, për të qenë më pranë qytetarëve të prekur nga përmbytjet, veçanërisht në jug. Deputetja Dhurata Çupi ishte në fshatin Bruç, të Matit, ku disa familje janë izoluar për shkak të përmbytjes së shtëpive, gjëse së gjallë dhe tokave bujqësore. Ndërsa deputeti i qarkut të Durrësit, Oerd Bylykbashi ndoqi nga afër situatën në këtë qytet, veçanërisht në Sukth dhe Katund i Ri. Bylykbashi tha se kryetari i Bashkisë së këtij qyteti, Vangjush Dako, ka sjellë pasoja të rënda në përmbytjen e këtij qarku, me abuzimet e fondeve për betonizim.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJII I POSAÇEM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjykatëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posaçëm të Apelit":

1 - Shpall vendet vakante për pozicionet:

Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Mardhënieve me Median dhe Publikun
Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Drejtësi.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

2. Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

3. Specialist Sekretarie Gjyqësore

- a. Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

4. Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve

- a. Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

5. Përkthyes

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht – Shqip.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
- c. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombetare.

6. Koordinator për mediat dhe mardhënie me jashtë

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit të arsimit të Lartë në Drejtësi/ Gazetari/Gjuhë-Letërsi etj.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e mardhënieve me median/ mardhënie me jashtë.

7. Specialist për prritjen me popullin

- a. Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë në Drejtësi.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

II - Rishpall vendet vakante për pozicionet:

8. Specialist Financë/Buxhet

- a. Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- d. Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

9. Specialist i Burimeve Njerëzore

- a. Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

10. Specialist IT

- a. Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inzhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- b. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- c. Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- d. Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- e. Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve eeb (Eordpress, Drupal, Joomla etj).
- f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

11. Specialist Protokolli/Arkive

- a. Kandidati duhet të plotësojë këto kriteret:
- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 11 Dhjetor deri më 15 Dhjetor 2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **"Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 15 Dhjetor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 11 Dhjetor deri më 15 Dhjetor 2017 në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopjet e dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), libërzetë pune) origjinal ose të notorizuar. Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësime positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

SITUATA POLITIKE

INTERVISTA

Nënkryetarja e Kuvendit rrëfen për reformën në drejtësi: Ishte universiteti i dytë

Vetingu, Hysi: Jemi në rrugë të mbarë, rezultatet e para në fillim të vitit

"Seancat, më të disiplinuar nën drejtimin e Ruçit"

Darina Tanushi

Nënkryetarja socialiste e Kuvendit, Vasilika Hysi ka pranuar të flasë për herë të parë, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" për propozimin që iu bë për të qenë numri "dy" i Kuvendit. Ajo shprehet se tashmë seancat parlamentare, nën drejtimin e Gramoz Ruçit janë më të disiplinuar.

Znj. Hysi jeni prej gati tre muajsh në postin e nënkryetares së Kuvendit. Si e pritët kur jua propozuan këtë detyrë?

Propozimi u bë në mbledhjen e kryesisë së Partisë Socialiste nga z. Gramoz Ruçi dhe u miratua nga kryesia. E mirëprita, pasi së pari është vlerësuar për kontributin e dhënë, por edhe mundësi për të pasur një përvojë pune në drejtimin e Kuvendit të Shqipërisë. Isha kurioze të punoja me z. Ruçi. E kam vlerësuar si sekretar të Përgjithshëm të partisë dhe kryetar grupi. Gjithnjë e kam vlerësuar z. Ruçi për faktin se nuk ka fjalë të shumta, është i prerë në marrjen e vendimeve, i qartë, i saktë, vlerësues për punën që bën, i jep drejtim shpejt dhe me pjekuri, pa lënduar, mbështetës për gratë në politikë. Dhe një aspekt i veçantë, që shumë pak vetë e njohin, është natyra njerëzore e tij, shpesh e palexuar në pamjen e jashtme dhe mes ekranit, por kush punon me të e vë re menjëherë. Mos harroj të them që është një njeri që i gjendet pranë njerëzve në shqetësimet dhe hallet e tyre. Besoj se do të jetë një përvojë e bukur në karrierën time në politikë.

Ju, për disa kohë, në fund të legjislaturës së shkuar, drejtuar Komisionin e Ligjeve. A do të donit të vazhdonit në këtë detyrë?

Unë vazhdoj të jem anëtare e Komisionit të Ligjeve dhe jam e kënaqur me detyrën e re që më është besuar. Megjithatë, ishte një



Nënkryetarja socialiste e Kuvendit, Vasilika Hysi

përvojë e bukur dhe shumë profesionale, ndonëse jo e lehtë, nëse mban parasysh që zëvendësoja kolegun tim, z. Fatmir Xhafaq që kishte krijuar profilin e vet të gjatë si kryetar komisioni dhe njeri me kontribute dhe reputacion në parti dhe në drejtimin e komisionit.

Përveç angazhimit politik, ju jeni edhe pjesë e universitetit. A do preferonit të riktheheshit me kohë të plotë në auditorë?

Nuk e përjashtoj si mundësi në një moment të karrierës sime. Nuk jam shkëputur nga jeta akademike, pasi ajo është shumë e bukur dhe aty unë fillova rrugëtimin e karrierës profesionale, 32 vjet më parë. Prej vitit 2009, jam angazhuar me kohë të pjesshme dhe dy vitet e fundit, më pak, për shkak të angazhimeve me reformën në drejtësi dhe punën si e zgjedhur. Përpiqem të gjej kohë nga koha ime private dhe familjare, të ndjek zhvillimet e fundit në fushë, të lexoj, të shkruaj artikuj ose kumtesa shkencore, të drejtoj ndonjë punim shkencor të studentëve në programin e doktoraturës. Të qenit në auditor me studentët/et dhe

diskutimet me ta për çështje të caktuara profesionale është një adrenalinë e vërtetë.

Sa ka ndryshuar parlamentin nën drejtimin e Gramoz Ruçit? A është bërë më autoritar ky drejtim, krahasuar me drejtimin e zotit Meta, kur koha që i linte për të folur ish-kryeministrit Sali Berisha ishte më e gjatë?

Seancat plenare kanë ndryshuar. Rregullorja e Kuvendit zbatohet më mirë ndaj cillido, ish-kryeministër ose kryeministër, deputet i mazhorancës apo i opozitës. Nuk mund të them se është më autoritar, por rregullorja respektohet dhe seancat janë më të disiplinuar. Autoritar ka kuptim shpesh negativ dhe që përjashton diskutimin dhe konsensusin në vendimmarrje. Z. Ruçi drejton Këshillin e Rregullores dhe atë të Legjislacionit, mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, mbledhjen e Byrosë. Shpesh është më tolerant dhe krijon hapësira për konsensus me shumë sesa vetë anëtarët e këtyre organeve. Pa dyshim, kjo është edhe shprehje e pjekurisë politike dhe përvojës së gjatë të tij. Tashmë,

JETA AKADEMIKE

"Nuk jam shkëputur nga jeta akademike, pasi ajo është shumë e bukur dhe aty unë fillova rrugëtimin e karrierës profesionale, 32 vjet më parë. Të qenit në auditor me studentët/et dhe diskutimet me ta për çështje të caktuara profesionale është një adrenalinë e vërtetë".



datët jogjyqtarë dhe jo-prokurorë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, më së fundi procesi po ecën. Si çdo gjë e re ka edhe vështirësi. Të mos harrojmë që bojkoti i opozitës për më shumë se tre muaj e pezulloj procesin e ngjyqësor të organeve të vetingut. Shpërndarja e parlamentit për shkak të zgjedhjeve pati ndikim në vet. Mund të them se zbatimi i reformës është në rrugë të mbarë.

Procesi i vetingut është një nga kushtet që ka vënë edhe Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Kur mund të quhet ky proces i përfunduar?

Bashkimi European ka vënë si kusht fillimin e procesit dhe rezultatet e para. Unë jam optimiste se do kemi rezultatet e para në fillimin e vitit. Për sa ju thoni për përfundimin e tij, mund të them se tashmë që ky proces ka filluar, besoj se afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligj do të mund të zbatohen. Konkretisht, organet e vetingut kanë disa përparësi në fillimin e procesit. Kështu, rivlerësohen me përparësi kandidatët gjyqtarë dhe prokurorë për Këshillat emrat e të cilëve janë depozituar.

Donald Lu ka folur për "peshq të mëdhenj" që do të kapen në fillim të vitit që vjen. Cilët mund të jenë këta?

Krimi i organizuar dhe korrupsioni kryhet nga "peshq të vegjël", por edhe "të mëdhenj" ose me në bashkëpunim me njëri-tjetrin. "Peshqit e mëdhenj" edhe nëse nuk janë direkt të përfshirë, ata me vendimet e tyre, mbështetjen mund të krijojnë lehtësira. Pa dashur të interpretoj fjalët e ambasadorit Lu, "peshqit e mëdhenj" janë ose kanë qenë jo vetëm në administratë, në nivele politike dhe në sistemin e drejtësisë, polici etj., por edhe në sektorin privat dhe mes njerëzve që drejtojnë ose financojnë

Përmbarsuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shjtje në ankand pasurine :
 *Toka Are truali nr pasurije 222/11 , vol 4 , face 83 ne Zonen Kadastrale 3652 ndodhur ne Ishitin Tush , Njesia Administrative Berdise , bashkia Shkoder
 Cmtimi me te cilin do te filloj shjtja ne Ankand per pasurine e siperpershtuar , eshte ne vleren 736.000 (shqateqind e tridhjetete e gjashtemije) lekë
 Shjtja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date 07.12.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbarsuesit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballje Gjykatës se rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara filmit te ankandit 10 % te vleres si garancë ne Bankën BKT dega Shkoder me nr logarje 41084051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL742065 1017 0000 6003 1383 9100.



“Opozita të bashkëpunojë për reformat, njerëzit nuk do ja falin”

Deputetja socialiste: Ju tregoj për “peshqit e mëdhenj”

Prokurori i Përgjithshëm? Nuk kam dijeni për diskutim emrash

kam dijeni për diskutim të emrave.

Opozita në deklaratat e saj ka ngritur alarmin për një përkeqësim të gjendjes ekonomike në vend dhe një reagim popullor që mund t'i vijë kësaj qeverie. A i "trembeni" një shpërthimi të mundshëm protestash?

Në çdo vend, opozita ka vetëm fjalën dhe gjithnjë kritikon programin e qeverisë, sidomos atë pjesë që është me e ndjeshme për qytetarët: ekonominë, punësimin, shërbimet shëndetësore, arsimin. Kuvendi sapo miratoi



KRYEPROKURORI

“Lidhur me Prokurorin e Përgjithshëm, Komisioni i Ligjeve do të miratojë kalendarin 3 javor të tij dhe do ta shohin nëse do jetë parashikuar në kalendarin e ri që miratohet të martën kjo çështje. Nuk kam dijeni për diskutim të emrave”.

← krimin e organizuar, janë koka e organizatave ose rrjeteve kriminale. Statistikat e politikës penale tregojnë se shumica e të dënuarve deri me sot, janë “peshq të vegjël”. Kam besim se profili i personave të procedurave dhe dënuesit për korupsion dhe krim të organizuar do ndryshojë nga ai që kemi sot.

Sipas jush a bën pjesë në këtë term të përdorur nga ambasadori i SHBA-së edhe ish-ministri i Brendshëm?

Lidhur me çështjen në fjalë nuk mund të pronomohem. Kjo çështje tashmë është në proces hetimi dhe tashmë fjalën e ka drejtësia. Le të presim çfarë do të rezultojë nga hetimi.

Në media ka nisur debati për Prokurorin e Përgjithshëm. Ndërkohë ju, si deputet të Komisionit të Ligjeve, keni pasur javën

që shkoi një takim me kryeministrin Edi Rama. A do të nisë mazhoranca procedurat e zgjedhjes së drejtuesit të ri? Po diskutohen emra aktualisht?

Gjithnjë media nis debate për çështje politike me shpejtësi, në fakt, i vjen koha diskutimit. Për sa i përket takimit, po ka pasur një takim të anëtarëve të Komisionit të Ligjeve me ftesë të kryeministrit. Unë nuk kam qenë për shkak të një angazhimi parlamentar jashtë vendit. Këto takime, kryeministri i zhvillon rregullisht, jo vetëm me Komisionin e Ligjeve. Lidhur me Prokurorin e Përgjithshëm, Komisioni i Ligjeve do të miratojë kalendarin 3-javor të tij dhe do ta shohin nëse do jetë parashikuar në kalendarin e ri, që miratohet të martën, kjo çështje. Nuk

zonte rritje jorealiste të disa treguesve të buxhetit. Një gjë duhet të kemi të qartë të gjithë në politikëbërësit: sot nuk ka njerëz që nuk kuptojnë se çdo vend mbahet me taksa dhe se taksat duhet të rishpërndahen në të mira publike sipas përparësive. Rëndësi ka të analizojnë nëse rishpërndarja e të ardhura dhe të mirave publike është në përputhje me prioritetet që kanë njerëzit dhe me programin e qeverisë që është miratuar në Kuvend dhe nëse shpenzimet janë transparente dhe përdoren me efektivitet. Këtu, opozita mund të flasë dhe të shprehë alternativat e saj. Lidhur me protestat, tashmë jemi mësuar. Opozita ka qeverisur 8 vjet dhe la shumë borxhe për

të paguar sa nuk mund të flasë sot. Ato u paguan nga qeveria “Rama 1”. Të mos flasim për informalitetin në sektorin privat, pabarazinë dhe klimën jo të mirë biznesit, për gjendjen e kopshteve dhe shkollave, për punën e zezë, nivelin e ulët të pagave, taksimin e njëjtë si atyre që kishin paga të ulta dhe atyre që kishin paga të larta etj., gjendjen e sistemit energjetik, ndërtime të leje, abuzimet me pronat publike etj. Çfarë ka bërë opozita të zbusë këto probleme të krijuara ose të mbartura dhe që i rëndoi më shumë gjatë qeverisjes së saj? Asgjë. Kjo mazhorancë dhe kjo opozitë kanë disa detyra dhe përgjegjësi për të ndasive politike: kryerja e reformave që integrojnë shqiptarët në

familjen e madhe europiane; kryerjen e reformës zgjedhore tani dhe jo pak para se të ofrohen zgjedhjet; bashkëpunimi për çështje me interes kombëtar. Nëse nuk duan të kontribuojnë në këto çështje me interes jopartiak, njerëzit nuk do t'i falin ata dhe këdo tjetër që pengon procese të tilla.

Uroj dhe shpresoj se opozita do të jetë konstruktive dhe do ushtrojë detyrat e saj mes mekanizmave demokratikë dhe parlamentarë. Ky është një shans që i është dhënë asaj dhe kryetarit të saj dhe që nuk duhet ta humbasë. Në pushtet vihet mes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Ndaj është koha për të bashkëpunuar për reformat dhe në veçanti për reformën zgjedhore.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **“Blerje programesh Software, për nevojat e Bankës së Shqipërisë”.**

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 11,400,500 Lekë**”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Hallili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 IBIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **“Blerje programesh Software, për nevojat e Bankës së Shqipërisë”.**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **26 Dhjetor 2017, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

NJOFTIMI I PERGJITHSHEM PROKURIMI

Shteti: Shqipëri
Projekti: Projekti i Mikrofinancës në Shqipëri
Sektori: Mikrofinancë
Mënyra e financimit: HUA e IDB (ALB 0030), HUA e ISFD (ALB 0031) dhe Granti i Asistencës Teknike (ALB 0032)

Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit FAF Sh.a ka marrë financim në shumën prej 5.30 milion USD, ekuivalent nga Banka Islamike për Zhvillim, në drejtim të kostos së Projektit Mikrofinanciar në Shqipëri dhe ka për qëllim të zbatojë një pjesë të ardhurave për pagesat për mallrat, punimet, shërbimet e lidhura dhe shërbimet e konsulencës që do të prokurohen në kuadër të këtij projekti. Ky projekt do të financohet bashkarisht nga Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit FAF Sh.a.

Projekti do të përfshijë komponentët e mëposhtëm:

- I. Skema e Mikrofinancës
- II. Ngritja e Kapaciteteve dhe Trajnime
- III. Auditimi Financiar
- IV. Vlerësimi i mikrofinancës
- V. Huluntimi i vlerësimit bazë / afatmesëm / përfundimtar

Prokurimi i kontratave të financuara nga Banka Islamike për Zhvillim do të bëhet përmes procedurave të përcaktuara në Udhëzimet për Prokurimin e Mallrave dhe Punimeve sipas financimit të Bankës Islamike të Zhvillimit (edicioni aktual) dhe është i hapur për të gjithë ofertuesit e kualifikuar siç përcaktohet në udhëzim.

Njoftimet specifike të prokurimit për kontratat do të ofrohen sipas procedurave kombëtare të blerjeve. Paraukullifikimi i furnizuesve dhe kontraktorëve do të kërkohej për kontratat e mëposhtme:

- I. Sistemi Qëndror i Bankës “MIS”

Manuali i ISSH/ Trajtohen personat mbi 70 vjeç

Pensioni social, pesë kushte për përfituesit, dokumentet që duhen

Ornela Manjani

Instituti i Sigurimeve Shoqërore publikon kriteret e përfutimit të pensionit social. Për t'u përfshirë në skemën e përfutimit personat duhet të jenë mbi moshën 70 vjeç, të qëndrojnë në Shqipëri, të paktën për 5 vitet e fundit, nuk plotësojnë kushtet për asnjë pension nga skema e detyrueshme dhe nuk ka të ardhura ose janë më të pakta se një pension social. Kushtet bëhen të ditura në manualin e publikuar së fundmi nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore citohet se pensioni social është një përfutim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfutit nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.

DOKUMENTACIONI

Për t'u kualifikuar si përfitues të pensionit social personat duhet të plotësojnë dosjen me dokumentet. Sipas manualit mësohet se duhet të dorëzohet fotokopje e kartës së identitetit; certifikatë familjare; deklaratë për gjendjen social-ekonomike; vërtetim nga zyra e gjendjes civile që është banor në Shqipëri për të paktën 5 vite nga koha që paraqet kërkesën; vërtetim nga organet tatimore, nëse ushtron ose jo veprimtari ekonomik; certifikatë pronësie dhe/ose akti i marrjes në pronësi/ në përdorim të tokës; vërtetim për ndihmën ekonomike dhe deklaratë nëse je aksionar apo bashkëpronar në aktivitetet ekonomike/ pasuri të patundshme, që nxjerr të ardhura.

MASA E PËRFUTIMIT

Sipas ligjit në fuqi janë dy kategori përfutimi. Masa e pensionit social është e barabartë me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i përsëritur në pleqërisë me 15 vite të siguruar me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014. Masa e pensionit social për personat që kanë të ardhura nga



DOKUMENTET

- Përfituesi duhet të paraqesë një herë në vit deklaratën për gjendjen social- ekonomike;
- Pensioni social tërhiqet nga përfituesi çdo muaj;
- Pagesa e pensionit social ndërpritet në rast se nuk tërhiqet, në qendrat e përcaktuara të pagesës;
- Pensioni social mbyllet kur konstatohet se ka të dhëna jo të vërteta, lidhur me kushtet ligjore të përfutimit;
- Pensioni social nuk ndërpritet në rastet kur përfituesi është për kurim në spital.

Pensionet



PËRFUTIMI MUJOR

Masa e pensionit social është e barabartë me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i përsëritur në pleqërisë me 15 vite të siguruar me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014. Pagesa mujore arrin rreth 7 mijë lekë.

burime të tjera do të jetë sa diferenca e pensionit social me të ardhurat e tjera që ka përfituesi. Në manualin e ISSH-së saktësohet se kri-

teret, procedurat dhe dokumentacioni për pensionin social përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.



UNHCR

United Nations High Commissioner for Refugees
Haut Commissariat des Nations Unies pour les réfugiés

INTERNAL AND EXTERNAL VACANCY NOTICE

ALB/TIR/17/GS/03

Office of the United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR) in Tirana, Albania is looking for qualified and highly motivated candidates interested to apply for the following position:

Title of Position: Protection Associate, G6
Position Number: 10008684
Note: The position has a lien until 03rd June 2018. The selected candidate will be deemed in replacement capacity until the lien is relinquished or until the regular incumbent returns to the post.
Duty Station: Tirana, Albania
Type of contract: Standard Position GS6 (General Service)
Tentative starting date: 1 January 2018
Duration: Initially 1 year
Application Deadline: 16 December 2017, 17:30 CET

1. ORGANIZATIONAL CONTEXT Define the role of the position within the team, describing its leadership role, if any, its external/internal work relationships or contacts, the contextual environment in which it operates and the scope of supervision received, and where applicable, exercised by the incumbent.

The Protection Associate normally reports to the Protection Officer or the Senior Protection Officer. He/she monitors protection standards, operational procedures and practices in protection delivery in line with international standards and provides functional protection support to information management and programme staff.

The Protection Associate is expected to coordinate quality, timely and effective protection responses to the needs of populations of concern and identify opportunities to mainstream protection methodologies and integrate protection safeguards in operational responses in all sectors. He/she contributes to designing a comprehensive protection strategy and liaises externally with authorities and partners on protection doctrine and policy as guided by the supervisor.

The Protection Associate also ensures that persons of concern are involved with the Office in making decisions that affect them, whether in accessing their rights or in identifying appropriate solutions to their problems. To achieve this, the incumbent will need to build and maintain effective interfaces with communities of concern, local authorities and protection and assistance partners.

The protection associate will have the overall supervision of border monitoring activities with the aim to enhance access to the asylum procedures and access to the Albanian territory. He/she will strengthen strategic partners at the national and local level in order to enhance UNHCR monitoring capacity, and facilitate coordination of governmental and non-governmental institutions. He/she will actively engage with civil society organizations, INGOs and the Ombudsman's office and explore synergies regarding protection monitoring and advocacy interventions. He/she provide technical support to Border and Migration Police (BMP) to ensure that persons in need of international protection willing to present their requests/applications in Albania, are adequately informed of their rights and responsibilities. Moreover, the protection associate will assist the Protection unit with capacity building initiatives to national authorities, relevant institutions and NGOs to strengthen protection related policies and procedures.

2. FUNCTIONAL STATEMENT

Accountability (key results that will be achieved)

- Stay abreast of political, social, economic and cultural developments that have an impact on the protection environment.
- Consistently apply International and National Law and applicable UN/UNHCR and IASC policy, standards and codes of conduct.
- Assist in providing comments on existing and draft legislation related to persons of concern.
- Provide advice on protection issues to persons of concern; liaise with competent authorities to ensure the issuance of personal and other relevant documentation.
- Assist in conducting eligibility and status determination for persons of concern.
- Contribute to measures to identify, prevent and reduce statelessness.
- Contribute to a country-level child protection plan as part of the protection strategy.
- Contribute to a country-level education plan as part of the protection strategy.
- Monitor Standard Operating Procedures (SOPs) for all protection/solutions activities.
- Manage individual protection cases including those on SGBV and child protection. Monitor, and intervene in cases of refoulement, expulsion and other protection incidents.
- Assist in identifying durable solutions for the largest possible number of persons of concern through voluntary repatriation, local integration and where appropriate, resettlement.
- Contribute to the design, implementation and evaluation of protection related AGD based programming with implementing and operational partners.
- Contribute to effective information management through the provision of disaggregated data on populations of concern and their problems.
- Participate in initiatives to capacitate authorities, relevant institutions and NGOs to strengthen national protection related legislation and procedures.

Responsibility (process and functions undertaken to achieve results)

- Stay abreast of political, social, economic and cultural developments that have an impact on the protection environment.
- Consistently apply International and National Law and applicable UN/UNHCR and IASC policy, standards and codes of conduct.
- Assist in providing comments on existing and draft legislation related to persons of concern.
- Provide advice on protection issues to persons of concern; liaise with competent authorities to ensure the issuance of personal and other relevant documentation.
- Assist in conducting eligibility and status determination for persons of concern.
- Contribute to measures to identify, prevent and reduce statelessness.
- Contribute to a country-level child protection plan as part of the protection strategy.
- Contribute to a country-level education plan as part of the protection strategy.
- Monitor Standard Operating Procedures (SOPs) for all protection/solutions activities.
- Manage individual protection cases including those on SGBV and child protection. Monitor, and intervene in cases of refoulement, expulsion and other protection incidents.
- Assist in identifying durable solutions for the largest possible number of persons of concern through voluntary repatriation, local integration and where appropriate, resettlement.
- Contribute to the design, implementation and evaluation of protection related AGD based programming with implementing and operational partners.
- Contribute to effective information management through the provision of disaggregated data on populations of concern and their problems.
- Participate in initiatives to capacitate authorities, relevant institutions and NGOs to strengthen national protection related legislation and procedures.

Authority (decisions made in executing responsibilities and to achieve results)

- Prioritize persons of concern for interview, counselling and propose protection support for individual cases.
- Enforce compliance of local implementing partners with global protection policies and standards of professional integrity in the delivery of protection services.
- Enforce compliance with, and integrity of, all protection standard operating procedures.
- Submit individual payments request for persons of concern for approval.

3. MINIMUM REQUIRED COMPETENCIES

- Judgement and Decision Making
- Analytical Thinking
- Political Awareness
- Stakeholder Management

4. ESSENTIAL MINIMUM QUALIFICATIONS AND PROFESSIONAL EXPERIENCE REQUIRED

- Education: Completion of secondary school. Additional certificate/training in International Law, Political Science or related field is required.
- Job experience: Relevant to the function: 6 years.
- Fluency in English and working knowledge of another relevant UN language or local language.

(In offices where the working language is not English, excellent knowledge of UN working language of duty station and working knowledge of English).

5. DESIRABLE QUALIFICATIONS & COMPETENCIES

- Good computer skills.
- Completed Protection Learning Programme.

IMPORTANT NOTE:

- Interested candidates should read the Terms of Reference carefully and apply if suitably qualified.
- Candidates are required to submit signed Motivation Letter and UNHCR P11 form.
- UNHCR P11 form and Supplement form are available: UNHCR Personal History Forms (open Hyperlink)
- Please note that any previous versions of the P11 will no longer be considered.
- Applications of father, mother, son, daughter, or siblings of a staff member of UNHCR cannot be considered;
- Applications will not be acknowledged. Only shortlisted candidates will be contacted and invited for the written test and the interview;
- Applicants with working experience in International Organizations, preferably United Nations, are highly encouraged to apply;
- For any query please contact: albt@unhcr.org

Interested candidates should submit their applications (Completed UNHCR Personal History (P.11) form, P11 Supplement form and Motivation Letter) electronically by e-mail to: albt@unhcr.org or in the sealed envelope addressed to: UNHCR Albania, Skenderbej Str., Gurien Building, 2nd floor, Tirana, Albania referring to the Vacancy Notice reference UNHCR: ALB/TIR/17/GS/03.

Deadline for submitting applications is 16 December 2017, 17:30 CET. Late or incomplete applications received without the above specified documents will not be considered;

Tirana, 1 December 2017

Aksioni antiinformalitet tatimet ushtrojnë 15 678 kontrolle në të gjithë vendin

Ornela Manjani

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve gjatë dy muajve ka ushruar kontrolle në 15 678 subjekte në kuadër të aksionit antiinformalitet. Ndërkohë që u bën thirrje të gjithë bizneseve dhe individëve të përfitojnë nga fshirja e detyrimeve deri në fund të vitit pasi në janar do të nisën ndëshkimet.

KONTROLLET

Lidhur me subjektet, të cilat kanë ndryshuar përgjegjësinë tatimore, nga të dhënat e DPT rezultojnë se janë 1548 të tilla, të cilat kanë kaluar nga biznesi i vogël në të mesëm, apo kanë ndryshuar, apo kanë ndryshuar kategori brenda biznesit të vogël. Nga verifikimet e bëra në territor, janë verifikuar 22 027 subjekte, ku 20.8% e tyre janë pezulluar për shkak se kanë rezultuar në shkelje. Sipas DPT, në këto dy muaj janë futur në skemën e sigurimeve shoqërore 898 punonjës, janë mbyllur 523 subjekte të parregjistruara dhe janë regjistruar 4467 subjekte të reja. Ndërsa, sa i takon mbledhjes së detyrimeve të prapambetura, kanë reaguar pozitivisht 2697 subjekte dhe vlera ka arritur shifrën 1 miliard e 928 milionë lekë.

FALIA

Si rezultat i procesit të fshirjes së detyrimeve për periudhën para vitit 2010 dhe atë 2011-2014, shuma e detyrimit të falur kap shifrën 17 184 miliardë lekë. Ndërsa përdorimi i kredisë për shlyerje të detyrimeve në nivelin principal rezultojnë të jetë në vlerën 1 miliard e 697 lekë. Ndërkohë që ka mbetur më pak se një muaj kohë për të përfutur nga fshirja, e bizneset mund të përfitojnë fshirjen e detyrimeve për periudhat përpara dhjetorit 2010, pra detyrimet

Tatimet, përfitoni nga amnistia, në janar nisin gjambat dhe ndëshkimet

Në dy muaj regjistrohen 4467 biznese të reja, mbyllën 523 subjekte



INDIVIDËT PËRFITOJNË

1. Heqja nga qarkullimi dhe çregjistrimi i mjeteve të transportit për të cilat nuk është kryer asnjë veprim deri më dhjetor 2011, si dhe shuarjen e çdo lloj detyrimi për këto mjete. Gjithashtu, për mjetet e transportit, të cilat nuk hiqen nga qarkullimi parashikohet shuarja e detyrimeve tatimore për periudhat 2010-2014, me kusht pagesën e detyrimeve 2011 e në vijim. Efekti 11.9 miliardë lekë
2. Përdorimi të krediteve apo mbipagesave që mund të kenë subjektet për të kompensuar fshirjen e detyrimeve tatimore, sipas parimit që, nëse është njëkohësisht debitor dhe kreditor, do të bëhet fshirja e detyrimit të mbetur.

mbi 6 vjet të vjetruara. Këto detyrime do të fshihen për të gjithë individët, personat fizikë dhe juridikë që kanë detyrime të paguara sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj. Sipas ligjit në fuqi fshihen efektet tatimore për detyrime si pasojë e lëshimit jo brenda së njëjtës peri-

udhë tatimore të kryerjes së furnizimit, të dokumentit që vërteton përjashtimin nga TVSH, ose si pasojë e moslëshimit të këtij vërtetimi, me kusht që në çdo rast aplikimi pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore të jetë paraqitur deri më 31.12.2014. Ligji i fal-

jes parashikon të fshihen detyrimet e pagueshme në doganë për TVSH-në e shtyrë dhe të paguar për makineritë dhe pajisjet, importimi i të cilave është përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas listës përkatëse në fuqi deri në datë 31.12.2016.

BIZNESET

1. Fshirjen e detyrimeve për periudhat përpara dhjetorit 2010, pra detyrimet mbi 6 vjet të vjetruara. Këto detyrime do të fshihen për të gjithë individët, personat fizikë dhe juridikë që kanë detyrime të paguara sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj. Totali i detyrimeve që fshihen 29.4 miliardë lekë
2. Pagimin e detyrimeve tatimore të viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2016, duke ofruar incentiven e heqjes së gjobave dhe kamatave nëse paguhet tatimi brenda 6 muajsh. Totali i gjobave dhe kamatave që falen 62.6 miliardë lekë. Totali i tatimit të pritshëm për t'u arkëtuar si rezultat i faljes së penaliteteve dhe kamatave 35 miliardë lekë
3. Në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore, do të fshihen vetëm gjambat dhe kamatat, jo detyrimi për kontributin.
4. Fshirja me të njëjtat kushte e detyrimeve tatimore të qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë.
5. Fshihen gjambat automatike për deklarim të vonuar (gjobjë 10 mijë lekë për çdo deklaratë të dorëzuar me vonë). Efekti i përafërt i gjobave 250 milionë lekë
6. Fshihen gjambat referuar neneve të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese. Efekti 15 milionë lekë
7. Fshihen gjambat për kompanitë e kasave fiskale.
8. Fshihen detyrimet e sektorit elektro-energjetik shtetëror për vitet 2011-2013 si rezultat i kontrolleve dhe penalizimeve nga administrata fiskale. Efekti 8,1 miliardë lekë
9. Fshihen detyrimet e pagueshme në doganë për TVSH-në e shtyrë dhe të paguar për makineritë dhe pajisjet, importimi i të cilave është përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas listës përkatëse në fuqi deri në datë 31.12.2016. Efekti rreth 1 miliard lekë



Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Pyll", me sipërfaqe 6000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/422 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 82, rregjistruar në pronësi të Shoqëria "Gjyzeli-BLB" sh.a, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 15,120,000 Lekë.

"Pyll", me sipërfaqe 1000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/424 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 81, rregjistruar në pronësi të Ylli Braka dhe Ermira Braka, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 2,520,000 Lekë.

"Truall", me sipërfaqe 2497 m², nga e cila 2497 m² truall dhe 161 m² ndërtesë ndodhur në Metalurgji Elbasan, me Nr. 432/3 Pasurie, Zona Kadastrale 3965, volumni 4, faqe 247, rregjistruar në pronësi të Armand Shuaipi, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2173 Rep, Nr. 1409/2 Kol, datë 24.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 3,133,065.6 Lekë.

"Arë+Truall", me sipërfaqe 4,500 m², nga e cila 400 m² truall dhe 176 m² ndërtesë, ndodhur në Sallmone, Durrës, me Nr. 178/1 Pasurie, Zona Kadastrale 3255, volumni 6, faqe 135, rregjistruar në pronësi të Bujar Gjyzeli, lënë si garanci hipotekore për Bankën Tirana sh.a me Kontratë Hipoteke Nr. 657 Rep, Nr. 311/1 Kol., datë 11.08.2014 dhe Kontratë Hipoteke Nr. 1512 Rep, Nr. 1356/3 Kol., datë 23.10.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 9,534,672 Lekë.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.12.2017.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

United Nations Development Programme



VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancy.

Post Title:	National Consultant on Ethnographic Research
Type of Contract:	Individual Contract
Project:	Promoting Inclusive Labour Market Solutions in the Western Balkans
Duty Station:	Tirana, Albania
Duration of Assignment:	15 working days during the period of December 2017 - January 2018
Deadline for Application:	December 8, 2017
Job Description:	http://al.undp.org

Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>. Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

'Nga kapja e shtetit te kapja e shoqërisë', sofistifikimi i krimit të organizuar në Shqipëri

Raporti: Ja harta e familjeve mafioze e kriminale në Shqipëri

Politika penale ka shkuar drejt zbutjes së dënimeve në 10 vitet e fundit


Vladimir Karaj,
Reporter.al

Gjatë dekadës së fundit, krimi i organizuar në Shqipëri është sofistifikuar përmes forcimit të lidhjeve me politikën dhe me institucionet ligjzbatuese. Paralelisht me këtë evolucion, studiuesit kanë gjetur se është aplikuar zbutje e dënimeve penale për krime si trafikimi i narkotikëve dhe organizatat kriminale në të tri shkallët e gjyqësorit.

Këto janë gjetjet kryesore të dy studimeve të mbështetura nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, të cilat u prezantuan për mediat të premtën gjatë një konference në Tiranë nga bashkautorit Fabian Zhilla, studiues i krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Studiuesi Zhilla prezantoi studimin mbi "Evoluimin e strukturave të organizuara kriminale në Shqipëri" dhe po ashtu atë mbi "Drejtesinë penale në Shqipëri", të cilët i ka realizuar në bashkëpunim me Besfort Lamallarin, tani zv.ministër i Brendshëm dhe Nita Shalën, avokate dhe kriminologe.

"Organizatrat kriminale në Shqipëri vijnë në kryesisht grupime fisnore, të cilat përdorin biznesin si fasadë".



proces që zbuloi se të zgjedhur në Kuvend dhe në qeverisjen vendore ishin të dënuar për përfshirje në krim të organizuar, tashmë jemi në fazën kur fëmijët apo të afërmit të personave të implikuar janë përfshirë në politikë apo edhe në sistemin e drejtësisë.

"Ata kishin paratë dhe lidhjet, investuan në edukimin e fëmijëve jashtë vendit dhe po ashtu kanë investuar në vendosjen e tyre në poste kyçe, në polici apo në administratat lokale", tha Zhilla, duke shpjeguar se kjo nuk ishte përfshirë në studim, por dilte si rezultat i punës kërkimore.

Ndërkohë, ndër gjetjet interesante të studimit për evolucionin e krimit të organizuar ishte ndërtimi i një harte të organizatave kriminale që veprojnë aktualisht në vend, që sipas studiuesve janë të fokusuara në qytete port si Vlora apo Durrësi, në Fier, në Shkodër dhe në aksin Tiranë-Elbasan.

Studiuesit po ashtu janë përpjekur të evidentojnë lidhjet politike të grupeve të caktuara. Ndërsa lokalisht ndarjet politike janë të theksuara, në Tiranë dhe Durrës grupet kriminale i ofronin shërbim ofertesit më të mirë politik.

Zhilla tha se megjithëse bëhej fjalë për një studim, disa prej personave të intervistuar dhe ekspertë që kanë dhënë ekspertizë për studimin e kanë bërë këtë në mënyrë anonime për shkak të frikës prej grupeve të ndryshme. Ai përshkroi një situatë të rënd-

uar, ndërsa theksoi se "Nga kapja e shtetit, organizatat kriminale kanë kaluar te kapja e shoqërisë".

Duke shpjeguar këtë, ai shtoi se një pjesë e këtyre grupeve kriminale kishin tashmë aktivitet nga sporti deri në sipërmarrje me shumë të punësuar në vend.

"ZBUT-JA" E DREJTËSISË

Kurba e zbutjes së dënimeve penale ndaj anëtarëve të organizatave kriminale. Grafik: Nga studimi mbi "Drejtesinë Penale"


Sa i përket studimit mbi "Drejtesinë Penale", studiuesit gjetën se vendimet për grupet kriminale kishin ardhur në zbutje, ndërsa përdorimi i gjykimt të shkurtuar linte pak hapësirë për shqyrtim të imtësishëm të dosjeve. Po ashtu, ndër gjetjet theksohet se ndryshimi i shpeshtë dhe i pastduar i Kodit Penal dhe atij të Procedurës ka sjellë probleme në punën e gjyqësorit.

Studimi po ashtu vëren se Gjykata e Krimeve të Rënda në shkallë të parë është gjithmonë më e ashpër në dënime se kolegjet në Apel apo edhe në Gjykatën e Lartë.

"Nga ana tjetër, shikohet se gjykatat e krimeve të rënda të nivelit të parë kanë një qasje më të zgjeruar për sa i përket interpretimit të neneve përkatëse që lidhen me format e veçanta të bashkëpunimit të kryerjes së veprave penale. Ndërkohë që Gjykata e Apelit dhe ajo e Lartë e interpretojnë ligjin ngushtësisht duke e bërë më të vështirë të provuarit e veçorive specifike të formave të ndryshme të bashkëpunimit të veçantë të trafikut të narkotikëve dhe krimeve të tjera të rënda, sidomos në rastin e organizatave kriminale," - thuhet në studim.

Po ashtu theksohet se shpesh gjykatat, edhe pse kjo nuk kërkohet nga ligji, i japin shumë rëndësi strukturës organizative "për të bërë dallimin midis bashkëpunimit të veçantë kundrejt atij të thjeshtë", duke bërë që dënimet të jenë më të ulëta.

Statistikat e përpunuara nga studiuesit në këtë rast tregojnë se ka një trend të zbutjes së dënimeve, i cili përfshin prokurorinë dhe më tej gjykatat e tre niveleve. Sipas statistikave, në vitet e para pas krijimit të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe Prokurorisë pranë saj dënimet e kërkua nga prokuroria ishin të ashpra dhe vendimet zbuteshin në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, vitet e fundit kërkesat e akuzës për dënime janë gati po aq të ulëta sa dënimet që jep gjyqësori.



Grafik: Masa mesatare e dënimit për të pandehur, të kërkuar nga Prokuroria dhe të caktuar nga Gjykata (3 nivele), sipas vendimeve gjyqësore të analizuara.

ALBtelecom
...me ju të përfitim

NJOFTIMI I ALBTELECOM SH.A.

ALBtelecom njofton të gjithë pajtimtarët e tij të telefonisë fikse se paketat për pajtimtarët Individual (+Fiks (1.499, 1.999, Super 30)) dhe ALBtv (Small, Small Filestare, Medium, Medium Familjare, Large, Large Familjare, Extra Large, Extra Large Premium, Super 100, Super 100 Premium), si edhe paketat për pajtimtarët Biznes (+Fiks (Large, Extra Large), Biznes ALBtv (Large, Extra Large), pas datës 11 dhjetor 2017 nuk do të jenë më të vlefshme për aktivizime të reja. Të gjithë ata pajtimtarë, të cilët deri në këtë datë, kanë lidhur ose lidhin kontratë për këto paketa, nuk do të preken nga ky ndryshim, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratë përkatëse. Tashmë, për të gjithë pajtimtarët Individual dhe Biznes, të cilët duan të lidhin një kontratë të re ose të rinovojnë kontratën ekzistuese në shërbimet fikse, ALBtelecom ofron paketat SUPERIKS, për të kombinuar të 3 shërbimet: IPTV, Internet dhe Telefoni Fiks, me çmime dhe vëllime shumë të favorshme.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123.

Duke u referuar disa rasteve konkrete, Zhilla tha se përpos dekriminalizimit, një


MONUMENTET



Përmblyten monumentet, uji nxirret me pompë nga kishat e Voskopojës

FATMIRA NIKOLLI

Imazhet që shihni janë të Kishës së Kryeengjëjve Mihal e Gabriel, në Voskopojë. Kisha është përmblytur nga reshjet e fundit dhe uji prej saj nxirret me pompë. Imazhet janë të Forumit të Trashëgimisë, por edhe vetë Ministria e Kulturës ka publikuar një foto që shihet pompa që tërheq ujin. Si rrallë herë, është vetë ministria që njofton për situatën e monumenteve. Në raste si ky i këtyre ditëve, janë mediat që raportojnë pa informacione zyrtare. Këtë herë, Ministria e Kulturës, përmes një materiali të detajuar, raporton për monumentet që rrezikojnë, nga jugu në veri. Deri tani, nga raportimet periodike nuk ka emergjencë në objektet e trashëgimisë, por situata të kontrollueshme në disa pika ku janë paraqitur probleme për shkak të përmblytjeve dhe reshjeve masive. Është duke u monitoruar me kujdes Ura e Golikut, e cila është nga më të rrezikuarat. Një grup pune po inspekton dhe monitoron objektin. Në qarkun e Durrësit paraqiten problematika për dy monumente: Kisha e Gjon Pagëzorit në Derven të Krujës Monument Kulture, është e përmblytur e gjithë zona dhe Forumi Bizantin (Macellum Forum), në Durrës për shkak të reshjeve ka rrëshqitje të dherave dhe disa gurëve të mbushjes së trotuarit. Sipas MK-së, janë marrë masat e menjëhershme për sistemimin dhe përforcimin e skarpatës nga punonjësit tanë. DRKK Gjirrokastër nga monitorimet dhe kontaktet nga terreni nuk njofton për dëmtime apo ngjarje në objektet e trashëgimisë. Sa i takon Vlorës, janë bërë inspektime



Një nga kishat e përmblytura

Ministria nxjerr specialistët në terren, ja objektet që rrezikohen

në: Manastiri i 40 Shenjtorëve, Manastiri i Mesopotamit, Kisha e Shën Premtes Lukovë, 3 Parqet Arkeologjike (Orikum, Amantia, Finiq), Kullat e Dervish Aliut dhe kanë pasur komunikime me banorët e zonës për monumentet Kisha e Shën Thanasit Leshnicë, Ujësllësi i Vranishtit, Ura e Bratajt, Ura e Slapit, Ura e Frëngut duke bërë me dije se gjendja nuk shihet të përkeqësohet dhe është pa probleme. Në Shkodër nuk shfaqen problematika në objektet e trashëgimisë për shkak të motit të keq. Pas inspektimit të bërë në objektet me risk me të madh situata paraqitet normale. Në xhaminë e Plumbit ka pak ujëra, por ato vijnë si rezultat i ujërave nëntokësore

pasi xhamia është nën nivelin e lumenjve Kir dhe Drin. Në kishën e Shërgjirit situata paraqitet normale po ashtu edhe tek ura e Mesit prurjet e lumit Kir nuk janë inten-

sive. Ministria bën me dije se janë duke u kryer monitorime të vazhdueshme në terren nga specialistët e DRKK Berat në "Qendrën Historike" të qytetit të Beratit, i cili nuk raporton probleme në monumente, veç qytetit, që pas shirave është mbytur në baltë për



sistemimin dhe përforcimin e skarpatës nga punonjësit tanë.

FIERI E KORÇA NË RREZIK

Në qarkun e Fierit, sipas Ministrisë së Kulturës, paraqiten problematika. Kisha e Shën Kollit në Vanaj, paraqet probleme në çatinë e saj, pasi nga shirat e tepërt rrezikon. Të njëjtin problem me çatinë ka edhe Kisha e Shën Gjergjit në Libofshë, sikundër edhe Kisha e Shën Marisë në Bishtqethëm. Ndërkaq, Kisha e Shën Gjergjit në Suk Strum, rrezikon pasi ndodhet në fushë. Drejtoria Rajonale e Korçës po monitoron Urën e Golikut, e cila është nga më të rrezikuarat, ndërsa në kishën e Shën Gjergjit në Shpëskë ka pasur lëvizje të rasave nga stuhia dhe MK, premtori që do të sistemohen sapo koha të jetë optimale. Po ashtu, në Vitkuq te Kisha e Shën Mëhillit ka pasur lëvizje të rasave në pjesën e hajatit ku po merren masa për t'i sistemuar,

sikundër Kisha e Shën Gjergjit, të cilën e kanë izoluar me mjete provizore. Në Kishën e Ristozit në Mborje një pjesë e mbulesës provizore është shkëputur, por pa asnjë dëmtrim serioz. Butrinti deri më tani, qyteti antik i Butrintit nuk ka pasur probleme, sipas MK-së. E qetë dhe pa probleme paraqitet situata edhe në Parkun Arkeologjik të Apolonisë, si edhe në Parkun e Bylisit. Raportohet se te Muzeu i Pavarësisë në Vlorë, reshjet e dendura të shiut kishin përmblytur oborrin, por si rezultat i bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë gjendja tani është normalizuar, ndërsa uji është larguar. Bëhet me dije se Ministria e Kulturës, Instituti i Monumenteve dhe Drejtoritë Rajonale Kombëtare në të gjithë vendin janë duke monitoruar situatën e vështirë, shkaktuar nga reshjet të dendura shiu dhe, gjithashtu, duke ndjekur orë pas ore situatën e objekteve të trashëgimisë në të gjithë vendin.

E DIEL
3 dhjetor
2017

MILOSA O



Enkas
për "Milosao"

Zbulohet dokumenti i Martin Camajt i vitit 1990

Pse nuk pëlqehet letërsia ime në Shqipëri, çfarë i duhet vendit tonë?!

NGA MARTIN CAMAJ

Tash afër një vjet ka nisë dhe në Kosovë një rëmim apo rikqyrje qëndrimesh e praktikash kundrejt kulturës e letërsisë shqiptare. Plogshia mendore trashëguese nga struktura ideologjike staliniste e të kaluemes po bie si perde e errët prej syve të njerëzve. Shumicës së shkrimtarëve posaçë të gjeneratës së re, si munda me e vretë tash së fundi edhe nga vizita në Prishtinë, i duket sikur zgjohen nga një andërr e keqe. Pyetnin veten e mue, përse u ndaluen veprat e mia deri sot? "Në to s'ka gjana të këqia!" Sikur të doshin tërthoraz me përligjë qëndrimet e Partisë, apo ku ta di unë se paskan pasë shkaqe etike të ndalohet kontakti me popullin tim. Me fjalë të tjera njerëzit arsyetojnë ende dhe pa të keq mbas kategorive të vjetra, si forcë plogështie. "As me

politikë nuk je marrë!", më thonë. Ndalimi i veprave të mia letrare e jo letrare në vendin tim nuk më ka befasue kurrë. Por së pari due të sqaroj një pikë: e kam pohue gjithmonë se *nuk jam njeri i politikës*, por nuk kam thanë se *nuk jam njeri politik*. Me fjalë tjera nuk jam vu kurrë në shërbim të një rryme politike, si vetje kam qenë gjithmonë në luftë (natyrisht me mjete të mia) kundër padrejtë-

sisë së fatit të njeriut, sidomos i atij që vuen, më ka prekë. Për mue ashtë e logjikshme që nga fillimi u ndaluen veprat e mia në Shqipni e ma vonë dhe në Kosovë.

Të marrim një shkas të posaçëm: në veprat e mia letrare si në lirikë, ashtu në prozë instiktivisht, pa paragjykime ideologjike, kam marrë anën e individit, e njeriut kall i vetëm. Përkundër letërsia e realizmit so-

cialist në Shqipni e hymnizon kolektivin dhe nga individ, përbamës i kolektivit, lyp nënshtrim, disiplinë, vetmohim etj. Nëse lexohen me vëmendje shkrimet që trajtojnë temën 'kolektiv' si në letërsi ashtu në traktate propagande, ke përshtypjen se flitet për një 'mekanizëm', jo për një tanësi njerëzish, që do përdorë si makinë për të krye një funksion prodhues për të mirën e një kolektivi tjetër jo-

prodhues dhe shfrytëzues.

Në letërsinë time ka edhe elementa rrymash letrare që nuk pëlqehen në Shqipni, ndër to dhe liria e përdorimit të formave. Me 'formë' nënkuptoj dhe gjuhën sepse edhe fjalët që duhet të përdorë shkrimtari janë të caktueme në Tiranë: ka fjalë e forma 'socialiste' apo 'kombëtare' asosh 'reaksionare' të ndalueme.



Vijon në faqen 15

Në këtë numër: Martin Camaj, Luan Rama, Majakovski përmes përkthimit të Faslli Halitit, Letrat e dashurisë së Ing. Gjovalin Gjadri përmes përkthimit të Ardian Ndreces...

A

ARGUMENT

NGA SHPËTIM ÇUÇKA*

24.

Poema "Nënë Shqipëri" (1974) është vepra më e gjatë në vargje e D. Agollit. Edhe vetëm kjo e dhënë ka peshën e saj në përcaktimin e vendit që poema zë në krijimtarinë e poetit, por edhe në historinë e letërsisë shqiptare në tërësi.

Dhjetë kapituj, një hyrje dhe një mbyllje – vetë kjo ngrehinë e veprës flet shumë për rëndësinë dhe vëmendjen e veçantë që i ka kushtuar poeti kësaj teme, për mendimet dhe përjetimet që ajo ka zgjuar në mendjen dhe vetëdijen e tij që përpara se të ulej të shkruante vargjet e para dhe deri në çastin, kur ai i mbylli përfundimisht fletët e dorëshkrimit dhe e quajti veten të plotësuar me atë që kishte nxjerrë nga duart.

Ç'dëshira e mendime do ta kenë shtyrë D. Agollin drejt hartimit të një vepre të tillë lirike gjithëpërfshirëse? Një arsye mund të ketë qenë patjetër përvjetori i tridhjetë i Çlirimit të vendit nga pushtimi nazifashist, me të gjithë ngarkesën që mbartte ky përvjetor për jetën e vendit. Një arsye tjetër mund të ketë qenë edhe nevoja e poetit për të bërë përgjithësimet e tij artistike jo vetëm të periudhës tridhjetëvjeçare që kishte kaluar shogëria shqiptare pas çlirimit, por edhe të historisë së luftës dhe përpjekjeve shekullore të popullit për një shoqëri të mbështetur mbi barazinë dhe drejtësinë reale të qytetarëve. Pa dyshim një arsye ka qenë edhe nevoja e D. Agollit për të parashtuar rritjen e tij si qytetar pas katër dhjetëvjeçarësh jetë dhe si krijues pas rreth dy dhjetëvjeçarësh krijimtari, pra, për të bërë në njëfarë kuptimi një dhënie llogarie të ndershme e me zemër të hapur përpara lexuesve, përpara vetë popullit, bir të të cilit e ndjeu kurdoherë veten, përpara ndërgjegjes së tij qytetare. Shkruan poeti:

Po hap në poemë fletën e parë, fletën e dytë,
Si fletët e portës ku kurrë s'kam hyrë;
Mbi supet e mi miliona yj çelin e mbyllin sytë;
Pas shpinës sime treni i kohës gjëmon duke shfryrë;

.....
Treni i kohës me yllin e kuq të Nënorit
Bën dritë mbi portën e re të poemës.

Dhe le të shikojmë se me ç'sy e me ç'zemër e sheh ai vetë poemën, le të përqipim të kuptojmë se sa e shtrenjtë ishte poema në përgjithësi, arti poetik, për poetin D. Agollin:

O mushkë xanxare, të dua xanxare,
S'të dua të butë si dele manare,
Të dua të çiltër, të dua të pastër,
S'të dua të fshehtë, s'të dua të ngathët.

Ç' dëshira e mendime do ta kenë shtyrë D. Agollin drejt hartimit të një vepre të tillë lirike gjithëpërfshirëse? Një arsye mund të ketë qenë patjetër përvjetori i tridhjetë i Çlirimit të vendit nga pushtimi nazifashist, me të gjithë ngarkesën që mbartte ky përvjetor për jetën e vendit.

Pse e shkroi Dritëroi "Nënë Shqipëri"



Të dy do kalojmë në shtigje plot derte,

Ti mbetu përherë xanxare e serte!

"Jeta është luftë, punë e parreshtur, mund e përpjekje. Dhe poezia nuk mund të jetë thjesht jastëk me pupla, por këngë dhe tinguj që shogërojnë këtë luftë e këtë punë, këngë dhe tinguj të vetë shpirtit", - duket sikur thotë me anë të këtyre vargjeve poeti.

Mendimet më mblidhen si bletët rreth nënës.

Nënë Shqipëri, nënë Shqipëri!
Trokasin rrokjet, trokasin vargjet,
Trokasin hapat në Jug e Veri,
Trokasin pikat nën strehët e pragjet:

Nënë Shqipëri, nënë Shqipëri!

Përsëri të pranëvendosura dhe të gërshtuara tema e rrugëtimit të jetës dhe tema e këngës së jetës, përsëri dhe përsëri, si një mënyrë e të jetuarit dhe e të përjetuarit të jetës. Dhe gjithçka, edhe rrugëtimiti edhe vargëzimi, në ritmikën e zhvillimit të tyre kanë një kumbim: mendimin e mëmëdheut. Të gjitha këto përjetime hyjnë të poema "Nënë Shqipëri" dhe njëkohësisht shërbejnë si hyrje në të, si hyrje e saj. Të ndalemi te vargjet, ku poeti na e hap zemrën, na rrëfëhet:

Nga gjithë qeniet e gjalla poeti
E do ledhatimin më shumë,
Se vuan i varfri, se digjet i shkretë
Për njerëzit natën pa gjumë.

Vargje që na kujtojnë të pavdekshmen poezi të Naimit "Fjalët e qiririt":

Në mest tuaj kam qëndruar
E jam duke përvëluar,
Që t'u ap pakëzë dritë,
Natënë t'ua bënj dritë.

Vargje që i bëjnë nder D. Agollit dhe i bëjnë nder letërsisë sonë, kulturës sonë.

Duke lexuar "Hyrjen" e duke shkelur në pllocat vargje të kreut të parë, duke u ndeshur menjëherë me çështjen themelore të kësaj poeme të madhe, me dashurinë për mëmëdheun, lexuesi i vëmendshëm e kupton: pas tridhjetë vjetësh çlirim D. Agolli e ndjeu moralisht të nevojshme ta shprehte në një formë të re dhe në përmasa të reja kuptimin e madh të jetës: dashurinë për mëmëdheun. Se vetëm kjo dashuri e bën njeriun të përqipet e të luftojë çdo ditë. Të vetë-flijohet, në rast nevoje!

Qëndroj para teje,
Ja tek më ke,
Për ty falem,
Për ty bëj be!

Jeton dashuria për ty,
Se birin tënd s'e thau civilizimi,
S'e thau shekulli i atomit
Dhe i zbritjes në Hënë;
Në buzët e plasura s'iu vyshk belbëzimi,
Belbëzimi i foshnjës që përgjërohet për nënë.

.....
Çdo gjë që më dhe trashëgim e kam mbajtur
Kudo që kam shkuar,
Kudo që kam vajtur.

Dashuria e poetit për mëmëdheun, për nënën Shqipëri, është dashuria për gjithë natyrën e vendit, është dashuria deri në entuziazëm për bukurinë e tokës amtare. Por kjo bukuria nuk është thjesht një kënaqje e syrit. Vendlindja, Shqipëria i duken të bukura jo kujt do. Ato janë të bukura për syrin e njeriut që e do vendlindjen, që e do Shqipërinë. Dhe shpesh te kjo dashuri ndihen edhe nota të hidhura: kur vendlindja shpërfillet e

shpërdoret, kur Shqipëria keqtrajtohet nga vetë bijtë e saj, kur vendi s'ka zot.

Dashuria e poetit për mëmëdheun, për nënën Shqipëri, është dashuria për këngën popullore, për krijimtarinë e popullit, për krijimtarinë që ecën në gjurmët e krijimtarisë popullore:

Mes dy malesh me dëborë
Ra një trim vetullahollë.

.....
O ju, korba, që po nxini,
Sytë e zez, të zez m'i lina,
Të shoh nënë, motër, grua,
Të shoh pragun mos m'u shua!

Po kjo dashuri për krijimtarinë popullore dhe ky vlerësim e kjo nxitje për krijimtarinë që ecën në gjurmët e krijimtarisë popullore e shtynjë poetin t'i përjetojë pa tolerancë tingujt dhe ritmet që vijnë a sillen nga jashtë, modelet e një produkti, që vetëm art e krijimtari e shëndetshme nuk mund të quhen dhe që ndotin kulturën e një populli ashtu si e ndotin natyrën e këtij populli sjelljet e plehrave të prodhuara në vende të tjera. Dashuria e poetit për mëmëdheun përmban dëshirën e shenjtë të poezisë "Mëmëdheu" të Çajupit: *ku rroj me gas e me shpresë, / ku kam dëshirë të vdes*. Ja si këndon D. Agolli:

O malet e mi,

.....
Kam marrë shumë nga ju e do marr!
Një copë gur do më jepni kur sytë të mbyll,

Një copë gur do më vini mbi varr

.....
Dhe unë at'herë do jem me ju i pandarë

Biri juaj në gjirin tuaj do flerë,
Dhe pylli këngës së tij do t'ia marrë
Dhe fyelli i përjetshëm do bjerë:
Vëlla poet, këngëtar i gëzimeve dhe halleve,

.....
Çlodhu pakëz në hijen e maleve!
Te koka në shekuj do rrjedhë burimi,

Mbi gjokë do hedhë fletët të kuqe agimi.

Vëlla poet, këngëtar i tokës e grurit,
Çlodhu pakëz në hijen e gurit.

Dashuria e poetit për mëmëdheun është dashuria për historinë e vendit, për historinë e popullit, dashuria për agimet dhe perëndimet, për mitet e legjendat. Por në këtë dashuri nuk ka vend për poshtërimet dhe ndotjet që i bëhen historisë së vendit dhe të popullit, ashtu si nuk ka vend për mite dhe legjenda, ku njerëzit dhe popujt poshtërohen. Dashuria për mëmëdheun buron

edhe nga kohërat e hidhura të mërgimit. Këndojmë vargjet:

Dhe zogjtë e tu të mjerë, të shkretë
Braktisnin të heshtur foletë;
Kabaja qante në gryka e zalle
Për botën e ndrydhur në halle;
Kabaja mbartte hidhërimin e maleve,
Si zemra e vajzës së valëve,
Që priste mbi gurin e zi anës detit
Mbetur si qyoqja në mes të rrëmetit.

Dhe ja ç'thotë poeti me gojën e mërgimtarëve:

Rruqa jonë, drejt o rrugë,
Zgjatet për një copë bukë,
Shkon në fundin e dynjasë,
Akujve të Kanadasë...

Dashuria e poetit për mëmëdheun është dashuria për Gjergj Kastriotin dhe Naimin, për Rrapo Hekalin, për Plaku e Florës dhe Selam Salarinë, për Avniun nga Libohova dhe Bajramin. Është për këta dhe të tjerë njerëz si këta...
Dashuria e poetit për mëmëdheun është dashuria syhapët e njeriut që nuk lejon copëtimin e vendit nga të huajt, është dashuria e birit që gërshetohet me urrejtjen e neverinës për ata, emrat e të cilëve janë dëgjuar në historinë e vendit, sidomos në periudha pushtimesh dhe në bashkëpunim me pushtuesit, ndërkohë që populli jetonte i kredhur në mjerim:

Xhambazët që e nxirrnin nënën në pazarin e zi të Ballkanit,
Bënin duva dhe kërcenin rreth kurorës së mbretit,
Trullusor nga tingulli i lirës së arit,

Dehur nga era e temjanit në oborin e madh të doletit...

Po tutje Myzeqesë kalbej kallami në balte,

Kalbej njeriu tok me kallamin e madh si zabel.

Bujkut i vinte dimri mes vapës,
Bujkut i shpinte dimrin mushkonja anofel...

.....
Dashuria e poetit për mëmëdheun është ndjenja e thellë e neverisë për jetën e shthurur dhe boshe të disave në mes të mjerimit të gjithë të tjerëve:

O jetë me myk nën qylaf, gostek, borsalinë,
Në dhembë të krimbur e tru të mpitë.

Më mirë të ngordhja për bukë diku në bujtinë,

Sesa të kisha të bëja me ty qoftë e një ditë!

.....
Fshatarit që dinte të bënte çudira me tokën e ngratë,

Që mund të krijonte nga balta vetë Adamin

Me sy me veshë, me dhembë,
Një hiç-bejlorcinë që kishte në vendin truve bathë,

Ibëheperëndi, i rrinte mbi kokë, evinte nën këmbë!...

.....
Dashuria e poetit për mëmëdheun është ndjenja e hakmarrjes:

Fshatari të gjitha i di pa letër e libër,
Fshatari librine tokës mësoi me durim:
"Do vijë patjetër një ditë
Të kërkojmë shpëtim,
Të kërkojmë shpëtim!..."

R

RETROSPEKTIVË

Vijon nga faqja 1

NGA MARTIN CAMAJ

FRIKË NGA MOSKUPITIMI

Mbetet e paharrueshme për mue diskutimi me autorët kosovarë prej 24-29 gusht 1990 në Prishtinë, sidomos me autorë të rij, temperamentesh të ndryshme. Kosova ka edhe kritikë letrarë të hollë; disa ndër ta janë përgatitë në Francë e Gjermani. Mbas largimit, mbetet dyshimi: a jemi kuptue? Nuk ashtë, e lehtë të jesh i kuptuem kur vjen prej një bote tjetër, me përvoja fare të ndryshme jetësore e kulturore, me tjetër shije sidomos për sa i përket formës, të gjykohesh si 'pedant', alergjik kundrejt çdo kakofonie...

Njerëzit e kulturës e të arteve shqiptare janë të ndamë tash 45 vjet në tri degë: Shqipni, Kosovë dhe Perëndim.

a) Në Shqipni sistemi stalinist ia doli që mes këtyne tri grupeve mos të ketë kontakt të natyrshëm kështu që secila degë autorësh u zhvillue në kushte specifike të ndryshme. Në Shqipni u pengue edhe ndërlidhja mes autorëve të vjetër e të rij; bile u shkaktue nga mbrendë dhe rivaliteti artificial mes të 'rijve' e të 'vjetërve': këto ndër tjera kushte demokratike, ta thomi gzatjet mes të resë e së vjetrës do të kishte qenë dhe frytdhanës. Disa nga të rijtë që sot qëndrojnë në krye të grupit kaluen do kohë dhe në Bashkimin Sovjetik: do pranue, ky kontakt me letërsinë ruse me traditë ndikoi pozitivisht sidomos në prozën shqiptare mbas 1960 në Tiranë. Mbas kësaj periudhe letërsia e realizmit socialist në Shqipni u zhvillue në një situatë shtet-rrethimi apo 'get-to'. Simbas pragmatikës staliniste në art e letërsi u zhvillue një model edukues e kontrollues mbrendë të cilit individualiteti i autorit nuk del në pah. Si pasojë e byrokratizimit të autorëve, bahet kronik 'stagnacioni' dhe qet krye diletantizmi, mosdallimi i talentit nga autorë të pataleutem, numri i të cilëve shtohet prej pesëvjeçari në pesëvjeçar.

b) Letërsia kosovare ka pasë një zhvillim jashtzakonisht specifik: lindi në kushte jonormale, iu desht të çohet në kambë me fuqi të veta fill mbas lindjes... Kjo ka pasë përparësi, por dhe kushte të vështira zhvillimi. Kritika letrare ka një punë të madhe përpara të cilës s'është si poezinë ashtu prozën në Kosovë. Sot, për ata që e kundërojnë për, së largu me simpati e gëzim (natyrisht kritikë të shquem letrare), shohin një zjarm të madh që ia përngjet 'kaosit'. Sikur t'i aviten do të zbulojnë fije të ndryshme aq sa janë letrarë që sosin në një pikë. Andaj letërsia kosovare ka nevojë për studiu të hollë që jam i bindun se i ka mbrendë, në plangun e vet.

Profesor Bardhyl Demiraj ka ofruar me dashmëri për "Milsoan" dokumentin e panjohur në dorëshkrim: Në arkivin personal të Martin Camajt (Lenggries/BRD) gjendet ndër të tjera edhe një material i lënë në dorëshkrim, si përpunim i shënimeve të dikurshme për një intervistë, dhënë "Zërit të Amerikës" në gjallje të vet. Materiali i padatur rezultoi të jetë përfunduar si i tillë pas vizitës së fundit të autorit në Kosovë, në gusht të vitit 1990. Këto shënime përcjellin natyrshëm jo vetëm kandin e stilit të thukët të shkrimtarit tonë të madh në rolin e kritikut letrar të spikatur, por edhe atë angazhim intensiv intelektual e social në vazhdimësi që karakterizoi mërgatën e tërë politike shqiptare përgjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Po ia përcjellim lexuesit këtë material me lejën e zonjës Dr. med. Erika Camaj e me dëshirën e mirë që ta ngjetrojë këtë perllë të medimit kritik letrar shqiptar, duke përjetuar natyrshëm forcën e gjykimit dhe fuqinë sintetizuese të autorit në përjashtjen e atyre proceseve konvergues dhe divergues që përjeton letërsia shqiptare në kohë e hapësirë...

Letërsia shqiptare sot dhe autorët e saj

(Nga shënime për një intervistë dhanë "Zërit të Amerikës")

Autorët kosovarë, si vetje të paruar, kanë kërkuë gjithnjë kontakte edhe me shkrimtarë shqiptarë në Perëndim; ndërsa ata si grup zyrtarisht deri tash vonë kanë qëndruë larg autorëve të mërgatës, por jo atyne arbëreshë, me të cilët u zhvillue një bashkëpunim i ngrohtë e frytdhanës, sidomos me shtypin e poezisë arbëreshe nga Shtëpia botuese "Rilindja".

c) Letërsia jonë, tue nisë të ajo ma e vjetra, ka lindë në Perëndim. Edhe një pjesë e veprave letrare të Rilindjes u shtypën në mërgim. Në këtë traditë përfshihet edhe krijimi poetik arbëresh, i cili mbas vdekjes së Zef Sqiroidi pati, mbas 1930, një pauzë sa që u fol edhe për sosje të kësaj letërsie. Kah fundi i viteve 50' letërsia arbëreshe pati një ringjallje, tue nisë me poezitë e tregimet e Dushko Vetmos në një tribunë të përbashkët që ishte revista "Shëzjat" (1957-1974) me letërsinë e mërgatës. Ndërkohë hyni në përdorim një emërtim i ri "letërsia e diasporës", nga i cili u hoq dorë ose nuk u theksue sepse neve s'na shkonte ndërmend të përdorëj shumësi (letërsi kosovare, letërsi e realizmit socialist,



Martin Camaj dhe Ibrahim Rugova



Martin Camaj

letërsi arbëreshe dhe e mërgatës) për një letërsi si kjo e jona që lindi në periudhën e Rilindjes kombëtare pothuajse njëkohësisht në trajta e kategori përmbytëse moderne. Pati një kohë kur autorët e mërgimit ranë fare në heshtje; ndoshta as nuk do të kishte shkruë kush ma nëse një pjesë e autorëve të mos kish gjetë strehim ndër disa universitete të Evropës e Amerikës Veriore, në një ambient të ngritur, ku mund të lërvroheshin edhe gjuha shqipe e kultura kombëtare. Tek disa ma të rij ndikuen dhe rrymat e letërsive moderne ku vlerësoheshin këto rryma, d.m.th. ndër universitete. Specifike për letërsinë shqipe në këto kushte ashtë se një pjesë e autorëve janë profesora universi-

Pranimi i letërsisë së harruar

Kthimi i autorëve të ndaluem mbrenda letërsisë; në vendin që u përkiste po kuptohet si imperativ i kohës. Ribotimi i klasikëve si i Fishtës, Konicës, Koliqit, Zef Sqiroidi etj. etj. do të bjerë freskim ndër lexues. Përmes leximit cilësor që ashtë akt i përjetimit artistik, pa të cilën s'ka letërsi do të përtrihen edhe veprat e autorëve të ndaluem. Ky proces receptimi nuk do të jetë i lehtë as për lexuesin shqiptar, por shqiptari - si e pata ndëgjue nga një letrar i vjetër para shumë kohe - ashtë i sqet e di ta ndajë shapin prej sheqerit.

tarë, si shumë autorë emigrantë të kombeve të Evropës Lindore, rusë, polakë, romanë etj. Ndër ta donë përmendë, Ernest Koliqi, Arshi Pipa, Bardhyl Pogoni etj. Këtu marr shkas t'u qes gjeneratat të reja ndërmend edhe kontributin e albanologëve tjerë që nuk ishin poetë, Namik Resuli, Stavro Skendi, Jakob Marlekaj e sa tjerë, të cilët gjithë së bashku dhanë një kontribut të madh për afirmimin e kulturës shqiptare ndër universitete të mëdha (në Romë, në Columbia University, Mynih, Mineapolis), ku gjuha e letërsia shqipe u ngrit si landë studimore universitare në një rangë me gjuhët e letërsitë botnore.

Me emigracionin e ri të vjetit 1990 e me daljen në mërgim të Ismail Kadares nis një tjetër fazë e letërsisë shqipe në mërgim: për t'u gamë me lot puna se edhe në mbarimin e këtij shekulli letërsia jonë për të qenë e lirë merr rrugët e mërgimit, në një kohë kur letrarët e mërguem nga Evropa Lindore e Juglindore kthejnë në vendlindjet e tyne.

TRI APO NJË LETËRSI?

Natyrisht, një!

Në këtë syzim u fol për strukturat e jashtme të letërsisë shqiptare gjatë pjesës së dytë të shekullit tonë. Ndajë në tri degë nuk përligjet me ligjet e normat e mirëfillta të mbrendshme të artit letrar të cilat janë në kundërshtim dhe i qesin poshtë kriteret politike. Edhe kufijtë politikë nuk mund t'i ndajnë kulturat nacionale. Kusht për kapërcimin e ndasive apo dallimeve përçase ka me genë 'harmonizimi' i ndryshmënisë në përmbajtje e forma edhe në letërsi. Dijekëqijtë, sigurisht edhe në të ardhmen kanë me i ra gjithnjë hafazit të vjetër, tue përfitue nga ploghshtia mendore e njerëzve, që ndryshmënitë e trashëgueme mes formave gjuhësore, për shembull, ose zakoneve e besojmave, do t'i përdorin si mjete përçase. Por s'to dalin sepse qysh tash gjeneratat e reja të shkrimtarëve e kanë kuptue se e posaçjame e ndryshmënia në art e në jetë e pasunon njerinë dhe se ushtrimi i një arti të tillë ashtë e drejtë njerëzore.

PRANIMI I AUTORËVE TË NDALUEM NË LETËRSINË SHQIPE

Kthimi i autorëve të ndaluem mbrenda letërsisë; në vendin që u përkiste po kuptohet si imperativ i kohës. Ribotimi i klasikëve si i Fishtës, Konicës, Koliqit, Zef Sqiroidi etj. etj. do të bjerë freskim ndër lexues. Përmes leximit cilësor që ashtë akt i përjetimit artistik, pa të cilën s'ka letërsi do të përtrihen edhe veprat e autorëve të ndaluem. Ky proces receptimi nuk do të jetë i lehtë as për lexuesin shqiptar, por shqiptari - si e pata ndëgjue nga një letrar i vjetër para shumë kohe - ashtë i sqet e di ta ndajë shapin prej sheqerit. Kuptimi i tanësisë letrare që u përshkue nëpër faza të ndryshme të historisë së popullit tonë, do të japë shkas ndër lexues të kuptohet edhe periudha e 40 vjetëve të fundit, koha e krijimeve të miteve të rrejshëm që s'ka të bajë me realizëm, skajim përcaktues i 'realizmit socialist'. Ky shpërpjestim në parqitjen e letërsisë sonë në 40 vjetët e fundit u shpjegue me saktësi në një intervistë me Ismail Kadare, dhanë "Zërit të rinisë" pak muej ma parë në Tiranë.

E dija se vjen kjo kohë me shansën që shqiptari të gjejë vetveten si pjesëtar i shoqnisë së përparueme, por se edhe unë do ta përjetetoja këtë kohë, këtë nuk e kam besue!

T

TREGIM

Autori na sjell një kronikë shqiptare në kapërcyell të dy sistemeve, por gjithnjë të futur në një aspekt disi historik-filozofik, që i shkon shumë autorit...

NGA LUAN RAMA

Dy netë më parë ai i kishte telefonuar në orë të vonë duke menduar i shqetësuar se ndoshta atë çast ajo po flinte.

- Alo?... Kejt?... më fal që po ju shqetësoj tani në këtë orë.

- Ah, jo, ende s'kam rënë... je poshtë në restoranti?... Unë mund të zbris.

Në zërin e saj ai kishte ndjerë një lloj dëshirë që të ishte me të dhe të kalonin bashkë atë natë, edhe pse vonë.

- Ah, jo... nuk jam aty... po ju marr nga shtëpia. Sapo mora vesh se sonte në mesnatë do të heqin statujën e Stalinit nga bazamenti, në bulevardin e madh.

- Ashtu, vërtetë? Si kështu? Duket e pabesueshme. Askush nga gazetarët këtu nuk di gjë për këtë.

- Jo, askush, duan ta heqin në heshtje të plotë. Sapo më njoftoi një miku im. Besoj se është e vërtetë.

- Çudi, pse në mesnatë?

- Kuptohet, s'duan zhurmë, gazetarë, njerëz që të komentojnë... dëgjo, sapo njoftova dhe Andrian dhe Hildën.

Ah, çfarë skupi! - lëshoi një pashtrime ajo me një lloj gëzimi e habie.

- Do jem përballë hotelit çerek ore para mesnatës. Ti e di, statuja është dy hapa përballë.

- A po, sigurisht... atëherë po ju pres!

Ishte hera e parë që i tregonte një afërsi të tillë. Kejt ishte një bjonde e këndshme, me një trup të derdhur si të një atleteje, por ajo që e bënte të vjetër të sahatit të buzëqeshja e saj e përherëshme, cka çlironte një mirësi të pafund.

Atë mbrëmje fillim dimri të vitit 1990, në Tiranë binte një llojë debore që vinte nga veriu, ku bora kishte filluar shtruar. Nuk bënte ftohtë, pasi dhe erë s'kishte. Njëzet minuta para mesnatës ai kaloi para kullës së vjetër të sahatit të qytetit duke i hedhur një sy akrepave të saj. Sheshi ishte bosh dhe ndonjë kallimtar shkante tutje bulevardit. Hodhi sytë në të djathtë, para "Galerisë së Arteve" dhe nën dritën e zbehtë të një neoni pikasë figurën bonxtë të Leninit. Ai qëndronte aty, stoik, me një vështrim të çuditshëm hedhur përballë tij, ku një turmë e vogël po mblidhej dhe një vjeng po afrohej. U dëgjuan zhurmat e pistoletave të dy minatorëve që mesa dukej po punonin të shkëpusnin statujën e Stalinit nga bazamenti i betonit.

Kur ata u afruan, një grup i vogël kureshtarësh, kallimtarë të vonët, ishin mblledhur aty të tërhequr nga zhurma e pistoletave. Të habitur, gazetarët pikasën së çuditërisht ata tre puntore, rrethuar nga disa policë, po punonin të shkëpusnin statujën. Kur ai u afrua me gazetarët që e ndiqnin pas një polic e ndali:

- Ku shkoni?... Është e ndaluar...

- Jam gazetar i Radios së Jashtë, me, - iu përgjigj ai dhe bëri përpara



Syri i qiklopit

duke i treguar kartën e tij. - Këta gazetarë të huaj janë me mua, - shtoi ai duke treguar nga Kejt e The Independent, Andrea i «La Stampa»-s dhe Hilda e «Radio-Bremen». Polici deshi ta ndalonte por ai kishte kaluar tashmë duke tërhequr me vete dhe tre gazetarët që e ndiqnin me një kureshtje të jashtzakonshme. Polici shikonte e habitur pa ditur se ç'të bënte, t'i ktheante apo t'i linte. Një vështrim që më së fundi dukej sikur thoshte: «E ç'më duhet mua të ngatërrohem me këta të huaj, kushedi ç'më ndodh nesër...».

Atë mesnatë heqja e statujës u bë shpejt. Mjaftuan prerja e shufrave të hekurit që e mbanin të lidhur pas bazamentit që vinçi të hynte në veprim. Andrea fotografonte me shpejtësi; Kejt kërkonte emrat e dy minatorëve me pistoletat në duar duke fotografuar njëkohësisht, Hilda me mikrofonin e saj të vogël i ishte afruar puntorit me pistoletë dhe kërkonte t'i thoshte se çfarë ndjente për këtë çast historik. Puntori qeshi, vështrroi nga ai, pastaj nga policët, mërmëriti diçka nëpër dhembë dhe në fund shtoi: «Sigurisht që duhej hequr... mjaft më!» dhe duke rrembyer përsëri pistoletën deshi t'i largohej kësaj interviste.

Kur ai ngriti sytë, vinçi, që mbante nderur monumentin e rëndë prej bronxi tundej lehtë në një pozicion të pjerët, gjysmë i përkullur. Sikur po e ngrinin nga varri. Lumturisht diktatori shqiptar, nxënësi më i zellshëm i tij, kishte vdekur dhe nën presionin e Perëndimit vazhduesi i tij, që deri atëherë nuk kishte guxuar ta prekte idhullin e klasikur të "katërt", pra pas atij të Marksit, Engelsit dhe Leninit, tani po tërhiqej. Udhëheqësi suprem nuk

e kishte ndarë nga tavolina e tij e punës, nga koka kreative dhe shtëpia e tij deri sa vdiq. Ishte një lloj Mesie. Portreti Stalinit shfaqej ngado në pankartat e mëdha, nëpër rrugë, plazhe, fusha e male, krahas portretit të tij. Madje emrin e Stalinit ia kishte vënë dhe një qyteti naftëtarësh.

Para se të largoheshin, Andrea e drejtoi edhe njëherë objektivin e aparatit drejt statujës e cila tashmë po zhvendosej mbi karrocërinë e kamionit që priste me motor të ndezur. Pastaj e drejtoi objektivin nga bulevardi përballë ku shuhej zbehtë përmendorja e Leninit, i cili shikonte në një heshtje të madhe largimin e pinjollit të tij që asnjëherë nuk e kishte dashur, dhe aq më tepër që shqiptarët e kishin vendosur përballë tij. Çide absurde!...

Më së fundi statujën e rëndë prej bronxi e shtrinë mbi karrocërinë e kamionit. Shkonin ta «varrosnin» sërrish, s'dihej ku, ndoshta në ndonjë fonderi. Atë mesnatë të vonë ai përshëndeti gazetarët që i shoqëroi deri në hyrjen e hotelit dhe u largua me nxitim për në shtëpinë e tij. Ndjehej i gëzuar: Në "Hotel Dajti", tre gazetarët jepnin lajmet e para të një ngjarjeje që Perëndimi e priste: heqjen e statujës së Stalinit. Një simbol binte. Tashmë kishte mbetur veç monumenti gjigand i diktatorit në shesh të qytetit. Atë natë, nëpër eterin e qiellit shqiptar, shpërndajej lajmi i jashtëzakonshëm.

Po kthehej. Kishte një lloj ngazëllimi, mbase ngaqë ishte një nga dëshmitarët e rrallë të atij moment historik. Papritur u kujtua se ishte pikërisht datëlindja e Stalinit. Koïncidencë apo e qëllim? Në fakt, para një vit datëlindja e Stalinit nuk ishte festuar si më parë. Nxtomte dhe kur mbërriti as vetë nuk e kuptoi si mbërriti aq

vonë. Të gjithë flinin. Mbas disa orësh, në mëngjes qytetarët e Tiranës që do të kalonin nga bulevardi do të konstatonin largimin e asaj statuje, e atij njeriu që i solli aq fatkeqësi gjysmës së Europës. Të nesërmen, në disa gazeta ishte botuar fotografia e qeshur e minatorit që jepte intervistë me gazetaren e The Independent, në gazetën La Stampa, si dhe statuja e varur në ajër e Stalinit që mezi mbahej nga vinçi.

Atë mëngjes shumë studentë që shkonin në universitetin e Tiranës dhe kalonin nga bulevardi, nuk e pikasën fillimthi se bazamenti i statujës ishte bosh. «Radio Tirana» s'kishte transmetuar asgjë për një ngjarje të tillë, madje as Radio-Televizioni Shqiptar e gazetat e ditës. Dikush papritur e kishte pikasur dhe njerëzit kishin ndalur. Të tjerë që erdhën në pas shikonin të habitur atë bazament pa të zotin e tij. Fytyrat e tyre ishin të qeshura: pëshpërma, të qeshura, thirrje të vogla dhe hapa që nxitonin drejt bazamentit në atë mëngjes të diellit. Një kohë tjetër afronte dhe kjo ndjehej në fytyrat e njerëzve që ndalonin, të cilët pothuaj instinktivisht kthenin kokën nga krahu tjetër i bulevardit ku spikaste Lenini, krahëhapur, me pallton e tij në dorë. «Po ky, kur do të hiqet?» - tha dikush mes turmës...

Lloha e borës s'kishte lënë asnjë gjurmë dhe dielli që ishte ngritur disi tregonte se do të bënte një kohë e bukur. Një ditë më vonë, bashkë me gazetarët, sipas programit, ata ishin nisur drejt jugut. Thjesht një vështrim i shpejtë rreth peizazhit shqiptar, njerëzve, qyteve të jugut, jetës të "planetit shqiptar" siç shkruhej shpesh në shtypin e huaj, meqë hyrja e gazetarëve, deri para pak muajsh

ishte pothuaj gjithnjë e kontrolluar. Një dritë e bardhë diellore mbulonte gjithçka. Ata u nisën me dy vetura të Parkut të Delegacioneve, siç përdorehin përgjithësisht për gazetarët apo miqtë e Shqipërisë. Gjatë gjithë rrugës, në sediljen e pasme, ashtu me lirshmërinë e saj të një çupëline ajo ishte ngjeshur afër dhe vazhdimisht e pyeste rreth qytezave që shfaqeshin, fshatarëve, ndonjë fabrike buzë rrugës, jetës së fshatarëve, efektit që kishte bërë heqja e Stalinit në popullsinë shqiptare, etj. Ndërkohë ai përgjigjej me një qeshje të lehtë që e bënte akoma më simpatik. Ishte i çliruar, pasi ishin vetëm dhe nuk kishte njerëz të tjerë përreth që mund të pëshpërisnin në veshët e «Sigurimit». Shoferi dinte veç dy fjalë anglisht si «Mirëmbërma», «Mirëmëngjes», «Faleminderit» dhe kaq. Pasi kaluan Fierin, ajo nisi t'i tregonte rreth jetës së saj, studimeve në Oksford dhe pastaj nisjen e karrierës në gazetari, fillimisht në një agjenci lajmesh. Duke qeshur i pëshpëriti afër veshit se s'kishte patur fat në dashuri, edhe pse ajo i kishte dashur me gjithë forcë ata që kishte njohur. Tani dua të bëj një fëmijë, i ishte shprehur ajo. Është shansi im i fundit. Tashmë i kam kaluar dyzet vjet të jetës time. Dhe pastaj kishte shpërthyer në të qeshura.

- Po ti? I ishte afruar ajo duke e parë drejt e në sy, për të dëgjuar sekretet e tij. Je i dashuruar?... Me kë? Me gruan tuaj apo dikë tjetër!

Ai qeshi dhe ngriti supet. S'dinte si t'i përgjigjej kësaj pyetje të komplikuar.

- Ah, e di, kjo është një pyetje e vështirë për ju burrat.

- Jo, por... - donte të justifikojë ai, - por ndërkohë ajo kishte hedhur sytë drejt atij imazhi mahnisht që shfaqej, sapo kaloi qafen e Llogarasë dhe kjo që lart, si nga dritarja e një avioni pikasje poshtë bregun e një deti blu me një plazh rëre.

- Ç'mrekulli?! - tha ajo dhe kërkoi të ndalonin makinën.

Ata zbritën dhe filluan të vështronin atë pamje të jashtëzakonshme dhe në të majtë, tutje, majat e larta të malit të Pikëllimës. Makina e gazetarëve të tjerë u shfaq dhe ndaloi pranë tyre. Gazetarët dolën duke marrë me vete aparatet e tyre. Herë pas here Kejt hapte krahët duke u mbushur me frymë, sikur të ishte në majat e Himalajeve.

Drekën atë ditë e hëngrën në Borsh, nën rrepet plot gurgullima të ujrave të burimit që zbrisnin nga lart. Pastaj shkuan në breg.

- Doni të laheni? - e kishte ngacmuar ai.

- E pse jo?... Megjithatë mendoj se duhet të jetë ftohtë, - ishte përgjigjur Kejt dhe duke ngritur pantallonat shkoi këmbëzbathur drejt ujit. - Me këtë det të bukur dhe me këtë diell Shqipëria duhej të kishte fytyrën e një vajze të bukur...

Ai harroi se ata vinin nga detet e veriut dhe se një kohë e fillë këtu për ta ishte si një vjeshtë e ngrohtë.

Në perëndim ata mbërritën në Sarandë. Edhe pse dimër, dukej si një ditë pranverë. Bënte ngrohtë. Moti çuditërisht ndryshonte shumë me veriuin shqiptar. Pasi

P

POEMA

Vladimir Vladimiroviç Majakovskij është një nga autorët më të njohur rusë të dekadave të para të shekullit XX. Ai ishte poet, dramaturg, regjisor teatri, aktor, artist e gazetar sovjetik, bardi i Revolucionit të madh Rus...

LUFTA DHE UNIVERSI

Dalat
e kohës,
që ka parë ritin
e konsakrimit tim ushtar.

«Dëgjoni!
Cilido,
që është i padobishëm, madje,
duhet të jetojë;
por nuk munde,
s'mundet
në varret e transheve dhe strehimeve
ta varrosim të gjalle:
vrasës!».

Nuk degjojnë.
Një nënoficer njëqind këlesh shtyp si një shtrydhëse.
Nga një vesh në tjetrin më qethen me kujdes.
Si shenjë,
në ballë
fiksuan kryqin
e rëkrutit.

Edhe unë tani do duhet të shkoj në perëndim!
Do të vazhdoj të eci atje poshtë,
gjersa sytë e tu do të më çajne
në rubriken
e të «vdekurve»,
i përbërë je në trup.

1.


Dhe ja
Mbi skenë,
i rënditur nga zjarr i madh i orkestrës,
kerceu një bark.
Dhe filloi!
U rrit në sytë, si në mijera lente.
Gjarperi.
Shkëlqente djersa si llak.
Befas
u ndal këthiza dridhësit,
duke fërfëllirë si një fuge.

Ç'ndodhi!
Kokat tullace u shktrinë në një hënë të velme.
Dhe sytë, duke u shqyer, u lyrosën.
Deri dhe plazhi,
Duke çarë shkumën e kripur,
hapi notullën mbushur me shtëpi.

Gumëzhinte.
Gojë,
si korrent elektrik,
përdrodi një «bravo».
Bravo!
Bra-vo!
Br-a-vo!
Bra-a-a-vo!
Bra-a-a-avol
Kush është,
kush?
Kjo fundërrinë me turinj bualli
kjo masë mishi?

Nuk do të fusësh bashkë me vargjet në volume
të qeta
britmen e inallit.
Këta janë nipat e Kolombit,
pasardhësit e Galileut,
që hingëllinjë në ngatërruar në rrejtën e mete-
oreve!

Por atje poshtë,
duke murmuritur në mbrëmjen elegante,
grate
dallgëzonin në një kapele të madhe me njëqind
pupla
Dhe burrat trokisnin mbi tastat e trotaeve,
pianistë të dërrmuar nga epshi trivial.



Djathtas,
majtas,
terthoraz,
vengër
duke ngushtuar prehrin e fushave,
rotulloheshin ngjitur në boshlin e tokës
karuzelë
Babilonikë
Babilonietësh,
Babiloni.

Sipër tyre
damixhanë
me gjatësi magjepsese.
Nën lo
krikella
si një gropë e dehur.
Njëzëit
kridheshin,
si një Noe xurxull,
ose në të qeshura ulëritëse
me turi prej mijera Kameve

Do të mbushen,
dhe pastaj,
brenda natës së verbër,
do të hedhin mishrat e tyre mbi pupla dhe pam-
buk,
do të zvarriten njëri mbi tjetrin me djersë
duke bërë që të dridhen qytetet me kërcitjen e
krevateve.

Toka rënohet
dritat e fenerëve
ju gërryjnë lekuren me një mori puçrash,
duke u dridhur nga agonia e qyteteve,
njëzëit gulçojnë
në një zgavër guri.
Mjekët
njërin prej tyre
e hoqën nga arkivoli,

për të kuptuar pakësimin e jashtëzakonshëm të
njerezve:
rubla sillej
në shpirtin e brejtur,
si një mikrob me putra ari.

Nga të gjitha anët
për të pezmatuar me shpejt
vdekjen,
duke bërë njëzëit të zienin gjer në buzë të çä-
tive,
zemrat, Diesel të fuqishëm të kapitaleve,
fusnin vagona gjaku të kontaminuar.

Dhe ju të qetël,
nuk mbelet për shumë kohë.
Shpejt
shina hekurudhore nëpër vena filloi
infeksionin e qyteleve në rrezitje të fshatrave.
Ku zogjle kendonin tani dhe sheshet zhurmonin.
Aty ku ishte pylli ka një shesh,
me një skëterrë me njëqind shtëpi.
Si faunë në gjashtë kale u hodhën në valle
një bordello, njëra pas tjetres.

Dielli ngrinte kokën e kuqërremtë,
me shulin mpiksor mbi buzët e fryra,
dhe s'ka forcë të ngrejë kokën:
gali, gali
kthehet në furrikun e netëve.

Dhe ende s'arrit në kohë
nata e zeze,
e shitur,
të shtrihet,
të pushojë,
në gjysmë hije,
kur mbi të
ka hedhur skeletin përvëlues
një ditë e re e pangopur, e unritur.

Sipër çatave të mbyllura!

Grusht jvësh,
uluri!
Vrapo e trembur, mbrëmje - murgesh!
Shkojme!
Mbi femrat fryhen
flegat,
të brejtura nga dhembët e kokainës!

2.

Kjo ndodhi në një nga vjeshtat:
ishin
kova përvëluese
të gjitha.
Dielli trazohej,
bojxhi i çmendur,

duke njollësuar pluhurin me një ngjyrë portokalli.
S'ka rëndësi se diku
mbi toke
rodhën zëra.
Të dobët.
Lëvizën në majë të gishtave.

Pëshpëritja e tyre largoi ankthin nga gjoksi,
por frika
nën kalfën,
me dorë të kuqe
zgjodhi, zgjidhi,
dhe bëri
padurimisht të qartë
që nese nuk mblihdeshin
njëzëit në tufa kompanish,
nese nuk hapeshin venat e atyre,
vetë toka, e infektuar,
do të vdisin Parisët
Berlinet,
Vjenat!

Perse u mallëngjyët?
Eshhtë vonë për t'u qaravitur!

NGA VLADIMIR MAJAKOVSKI*

Ju jeni mirë!
Për të vdekurit nuk ka çnderim.
Mbyt urrejtjen
për vrasësit e vdekur!
E lan uj me i pastër
mekatin e shpirtit që ngrihet fluturim.

Ju jeni mirë!
Po unë,
mes mizerisë,
mes ropamës,
si do t'ia çoj të gjallit dashurinë?
Do të pengohem:
dhe thërrimja e dashurisë së fundit
përgjithmonë ajo do të shkrije në një shtjellë
tymi që nxin.

Ç'u intereson atyre,
atij që u kthye,
nga trishtimet tuaja?
Ç'u intereson atyre,
një thek me vargje?
Ata
mbi një palë këmbë druri
do t'u duhet të çapiten çdo ditë.

Ke frikë!
Frikacak!

Do të të vrasin!
Dhe kështu,
për pesë vite të tjera, skllav, do mund të vegjë-
tosh.
Gënjeshtrë!
E di,
në llavën e mësymjeve,
do të jem i pari
për heroizëm
dhe guxim.

Oh! por kush
para thirrjes së kambanës me çekan
të vilëve të ardhshëm
s'do të dojë të behet i gjalle?
Të gjithë!
Dhe unë
mbi toke
do të jem
i vetmi lajmëtar i së vertelave të ardhshme.

Sot gëzoj!
Pa e cirkosur
shpirtin
kam ditur,
kam ditur ta çoj deri në fund.
Njëzëori i vetëm,
mes britmave,
kllitjeve,
unë ngre tani
zërin.

Dhe pastaj
pushkatomëni,
lidhmëni në shtyllë!
S'do të jem unë ai që ta çngjyros!
Dori
që një as
të më godasë në ballë,
që më e kthjellët të shndrisë shënja?

Kushtuar Liliat

1915.

Në fillim, duhej të mendonit pendimin!
Mijëra duarve të mjekeve
u shpërndahet
arma e bisturisë nga magazinat.

Italia!
Eshhtë e qartë
për mbrelin,
per berberin, mbase,
që nuk ka ku te perplas kokën!
Ende sot gjermanët
Fluturonin
mbi Veneciel!

Gjermania!
Mendime,
libra,
muzera
të zhdukur
në gojet e hapura të armëve!
Grykë të zjarreve kercellini dhembët!
Studentë,
galoponi me kalin e Kantilit!
Thikën midis dhembëve!
Shpatat zhveshni!

Rusit!
Mos ka ngrirë vallë Azia kusare?
Në gjak dëshirat valojnë si një hordhi.
Zvarritni jashtë Tolstoe të perkulur nën Ungjill!
Per këmbet hollake!
Mjekra mbi gure!
Francë!
Pusho pëshpëritjen e ëmbël nëpër rrugët!
Të rinjtë duhet t'i hedhësh në valle të reja!
Dëgjon, e dashur?
Eshhtë bukur
në zhurmën e mitralozit të djegësh e të përdhun-
osh!

Angjll!
Turq!
T-r-a-a-k!
C'ishte?
Më duket se dëgjo!
Mos u trembni!
Një marrëzi!
Tokel!
Shikoni,
Çfarë ka mbi flokë!
lu shtrinë mbi ballë rrudha llogoresh!
T-s-s-s-s-s-s-s-s...
Një rropame.
Tambure, muzikë?
Eshhtë e mundur valle?
Eshhtë ajo,
pikërisht ajo?
Poi!
Filloi.

3.

Neron!
Përsëndetjel!
Të pëllqen?
Spektakli i teatrit më të madh.
Sot
kacafyten,
Shtet kundër Shtetit,
gjashëmbedhjetë gladiatorë të zgjedhur.

Ç'janë legjendat mbi masakrat e Cezarëve
para historisë
që eshtë zhvilluar gjer tanit!
Si një agim mbi një fytyrë feminare,
eshhtë e embel për ate
hiperbola me monstroze.

Do të rrotullohesh si një ketër në rrotën e së
qeshurës,
kur hiri yt do të dije
se sot
bota
eshhtë e tëra një Kolose,
dhe dallgët e të gjitha deteve të saj
janë mbuluar me vello.

Tribuna janë shkëmbinjtë,
dhe mbi shkëmb atje,
sikur beteja t'i kishitë t'hyer dhembët,
qiejt e katedraleve, skelet pas skeletit,
u ndezën,
duke u qarkuar nga kangjelat.

Sot
si një blic mbi tullacërinë tokësore,
duke përgjakur trazimin e turmave,



e tërë Evropa eshtë në flakë
varur në qiell
si një llambadar.

Erdhën,
për të bujtur në luginat tokësore,
miq
me pamje të tmerrshme.
mbi qafat e gjata shkëndijojnë zymtesisht
gjerdanë topash prej hekuri.

Ari i sillavëve.
Mustaqet e zeza të maxharëve.

Njollat e zeza të zezakëve.
Radhet e të gjitha lartësive tokësore
ajo i ka mbledhur nga koka të këmbët.
Dhe atje,
ku Alpet,
duke e ngrohur në perëndim,
përkëdhënin në qiell faqen prej akulli,
aviatorët depertues ngriten kreshten
e galerive të reve.

Dhe kur mbi arenë
luftrat
erdhën
në cifte festive,
duke çuar me kilometra rropamën e dyfishuar
nga teatri,
dhe gjëmimi i ushtrive prej miliona njerëzish,
globi tokësor
shtrengoi polet
dhe u mpi në prillje.
Oqeanet e thinjur
zbritën nga brigjet,
duke futur në rërë syte e turbullt.
Për pasarellet flakëruese
dielli perëndoi,
arbitër i rreptë
elem.
Duke u djegur prej kuriozitetit
zvarriten nga orbitat sytë e yjeve.

Por çasti nguron.
Eshhtë dembel.

Në fillim të lojërave të përgjakshme,
tendosur si një shoqërim,

çasti ndalet pa frymë.

Befas
çasti thyhet në mijëra copa.
Arena fundoset në një zgavër me tym.
Në qiell eshtë urrejëre e plotë.
Dhe çaslet u ngutën, u ngutën:
gërmaan,
bertillen,
shqyen.
Si shkumë njera pas tjetrës të shtënat
eshtë në flakë në bastionin e përgjakshëm.

Përpara!

Nga britma u dridh gjoksi i divizioneve,
Përpara!
Shkuma në gojë.
Shën Gjergji që tronditet në lëvizjen e flamujve,
tambureve:

Mashtrues!
Pergallit kalafalkunt!
Vejusha në turme.
Por janë ende pak.
Dhe në qiell
ngrihet
fishkëzjarri i fakteve,
njëri me monstroz se tjetri
Me sy të shqyer,
fari
prapa maleve
permes oqeanëve qante:
dhe në oqeanë
skuadrat përdridheshin
të ngulura në shtyllen e minierës.

Në një makt më të laturisur nga ferri dantesk,
tingujt e bronzte, rraskapitur me uturimin e
hingëllimave
duke u dridhur per Paris,
Joffe
mbi Marna
mbrohët me çetën e fundit.

Në jug
Konstandinopojë,
xhamitë duke kërcellitur,
vulli
të masakruarit
në Bosfor.

Dallgë,
hidhini, me dhembë të futur
në mbeturinat e fundit të bukës së konsakruar.

Pylli.
As edhe një zë.
Një heshlje
që duket gjer e rreme.
Të tyret dhe tanët u përzienë.
Dhe vetëm
korbat dhe netët kalojnë,
duke u veshur me të zeza, si një rresht murgjish.

Dhe rishmëzi,
gjoksi prej goditjeve duke u zhveshur,
duke pluskuar mbi pranverat,
duke kaluar nëpërmjet dimrit,
armatë pas armatë
rresht pas rreshti,
përmbytin milje tokë.

Ndizet.
Një rresht me lisa të rinj.
Një pentagram zjarri mbi prag të livadhit.
Nga vëlëtimat disa tela me gjemba
u copëluan e u karbonizuan.

Baterilë e benë inkandeshent zhegun.
Hidhen mbi kadavrat e qyteleve dhe fshatrave.
Me turinj të bronzte shqyenjë
gjithçka.

Zjarr shkatërrues!
Ku nuk do përplasesh, duke ndëshkuar!
Do të futem në një raketë,
në qiell do të arraisem duke vrapuar:
nga qielli,
i kuq,
mbi tokë duke u djegur,
gjaku i Pegut.

Dhe tokë
dhe ujë,
dhe ajër gërmon
Ku do ta drejtojë hapin e rrëmbyer?
Tashmë i çmendur,
tashmë duke qarë me furi
shpirtit lutet duke vrapuar:

«Lutë!
Mjaft!
Qelesit!
Eshhtë lakurige toka tashmë».
Të varret u derdhen të yshtur nga hovi
dhe ende
për një çast
vrapojnë pa koka.

Por mbi krejt këtë
djalli
nxjerr një shkëlqim gogësimash.
Në konstelacionin e hekurudhave
eshhtë
qielli i Berlinit,
i shndritur nga fabrika e eksplozivit.
Askush s'e di
nëse cikë
apo vile
kanë kaluar që kur mbi fushën e luftës
gjakun e parë kanë dhënë në luftë
duke e pikuar pikë pikë në kupen e tokës.

Njelloj:
dhe gurin
dhe moçalin
dhe fushën
kanë larë me gjak njerëzor.
Gjithandej
hapat
njelloj kanë spërkatur
duke trazuar ballen tymosëse të botës.

Në Rostov
një punëtor
në pushim festiv
deshi
të shtyrdhë ujin për samovar,
dhe bëri një kercim prapa:
nga gjithë tubat pikonte
e njëjta çorbë e kuqërremte.

Ndër telegraf rropateshin makinat Mors
Flisnin duke bërtitur disa të rinj qytetit.
Në ndonjë vend,
në Vangankov,

varrmihësi nisi të tundej.
U gjallëruan mbajtësit e pishtarëve në Monakon
e trishtuar.

Në plagën e madhe të disfatës së regjimentit.
reflektorët futën putrën e skuqur.
Ngritën një prej tyre,
dhe e hodhën në transhe
atë
që ishte mbi thikë!
Biblikë në fytyrë,
nga gropa
një zhgun.
«Kujtoni!
Me ne!
Jam Ponc Pilati!»

Por era e predhëve
në copa shqeu
mish dhe veshje.

U shqit nga tymi një skuadron kokash.
Hiç sy lotues!
U veshën
nga gazi.

Krahë të bardhë u rritën në shpirt:
grahma e ushtarëve arrin në fushqetë.
«Ti që fluturon në qiell,
mbyt,
mbyte
filmtarin».

Gjoksi rreh jo rregullisht...
Një shaka?
Në shtëpinë e Zolit?
Portën e parajsës së blindur prej reve,
çaj me një shqelëm.

Tranden engjëjt.
Kam deri meshirë për ta.
Ovalen e fytyrës e kanë më të bardhë se pu-
plat.
Ku janë,
zolat!
«Ia kanë mbalhur,
ia mbathën të gjithë:
Sabaoth,
Bud,
Allah,
Jehova»

Një gjëmim.
Një ahl!
Një uhl!
Por kaloi rrahja me top: smorzata
vetëm psherëllti
dhe u shua.
E u zvarritën jashtë me të bardhë.
U lutën:
«Nuk duhet!»

Askush nuk kërkoi
që fitorja
t'i atribuohet ajdheut.
Por ç'djali shërben
eshtra pa krahë e dreqës së gjakut?
I fundit u ngul mbi bajonetë.
Tanët shuhën në Kovmol
në dy metra
mish njerëzor i copëtuar.

Dhe kur u qetësuan
të gjitha ato që ngjanë,
duke u shtrirë
batalion pas batalioni
vrapoi vdekja jashtë
dhe mbi kufoma filloi të vallëzojë,
Taglioni pa hundë i baletit të skeleteve.

Kërcim.
Era nën majë të këmbës.
Shpupuris qimet e kolbakeve,
Përkëdheli dy fije floku mbi një të vdekur.
dhe kaloi përtej,
duke fryrë lehtë.

Të pestën ditë
në kokën e shpuar
i zbërthyen trenat udhëtim pas udhëtimit.
Në vagonin që kalbet
mbi dyzetë njerëz
kalër këmbë.

vijon

*Përktheu Fasil Haliti

Opinioni **i** Ditës

Varfëria, si forma më e hapur e dhunës ndaj popullit

Nga Rovena Hoxha

(vijon nga faqja 1)

... janë shtuar dukshëm të varfrit, kurse mbi 60% e pasurisë në vend është gllabëruar vetëm nga 4% e njerëzve të pasur. A ka njeri që nuk e kupton këtë hendek sh-tresor?

Është e vështirë të japësh një përkufizim për varfërinë, sepse ajo ndryshon nga një periudhë në tjetrën dhe nga një vend në tjetrin. Përveç kësaj, varfëria mund të matet dhe vlerësohet në mënyra të ndryshme. Kështu, ndryshe nga gjitha vendet europiane, në Shqipëri vetëm 7% e të varfërve asistohen me bonus ekonomik nga qeveria shqiptare; kjo shifër do të thotë se, shteti i një nuk është aspak një shtet social me qytetarët e vet në nevojë. Përkundrazi, në vendin tonë varfëria evoluon frikshëm dita-ditës.

Varfëria është një dukuri komplekse, që përfshin dimensionet e ndryshme të mangësive, ndër të cilat pamjaftueshmëria e produkteve utilitare dhe e shërbimeve është vetëm njëra anë e shfaqjes. Varfëria fillon me uri mbi të gjitha për ata që e provojnë realisht, dhe mbaron me poshtërimin që ndjen nga jeta dhe nga të tjerët. Sepse, ashtu pa e kuptuar fare, një ditë shtrëzohesh lehtë fare në "një të varfër".

Tek ne, ajo nuk identifikohet vetëm me të papunët apo me familjet që jetojnë në varfëri ekonomike, por përfaqësohet, gjithashtu, me kategori, të cilat janë të përgjash-tuara nga të drejta themelore për të pasur një banesë, ushqim të mjaftueshëm, ngrohje dhe veshje në dimër, punë në përputhje me aftësitë fizike dhe nivelin arsimor, shkollë afër shtëpisë dhe mundësi për ta ndjekur atë, akses në shërbim shëndetësor, mbrojtje nga grabitja dhe dhuna, të drejtë dhe zë për të kërkuar të drejtat. Megjithatë varfëria është identifikuar si një pabarazi në shpërndarjen e të mirave materiale midis shtresave të ndryshme të popull-sisë, («të ardhurit» është aktualisht, indikator më i rëndësishëm dhe më përfaqësues i pabarazisë dhe varfërisë. Realisht sot, një ndër 5 pensionistë në Shqipëri nuk përfiton pension pleqërie. Atëherë, po çfarë ndodh realisht me ta??? Si mbijetojnë ata vallë?

Të jesh i varfër do të thotë të mos kesh strehë, të jesh i sëmurë dhe të mos kesh mundësi të vizito-hesh të mjeku; do të thotë të jesh i papunë dhe të mos kesh një të ardhme të sigurt; madje të jesh analfabet, të mos kesh mundësi për kushte shëndetësore dhe të të mu-ngojnë shumë shërbime e mjete për jetën e përditshme. E mbi të gjitha ndjehesh i dhunuar nga kur-reti yt, e nuk ngrihesh dot kurrë



më.

Por, ndërsa Shqipëria para 1990 i përkiste realizmit socialist të asaj kohe, në të vërtetë ajo ishte krejt e izoluar, vendi më i panjohur në Europë si dhe një ndër vendet më të panjohura në botë. Pikërisht ky izolim pengoi zhvillimin e vendit dhe favorizoi varfërinë midis popullit. Ai sot ka prekur fundin dhe përqaftuar varfërinë, i lodhur tash-më nga 27 vite tranzicion të pafund ende.

Faktikisht, kalimi në rrugën e ekonomisë së tregut, në vitet '90, u shoqërua me mbylljen e industrive dhe aktiviteteve jorentabël, rritjen e nivelit të papunësisë, varfërisë dhe emigracionit. Zhvillimet e reja u shoqëruan edhe me thellimin e pabarazive ekonomike dhe sociale dhe krijimin e grupeve dhe individëve të ekspozuar ndaj rrezikut të për-shashtimit social. Por, ajo që trish-ton sot, është se varfëria në këtë fillim shekulli në Shqipëri ka prekur edhe moshën e re.

Sipas statistikave vetëm 10% e popullsisë së varfër janë të moshës 60 vjeç e lart. Në të kundërt me popullsinë e të rinjve, që ose është e papunë, ose varet prej familjes, pensionistët kanë të paktën një të ardhur minimale (pension të garantuar nga shteti), që vjen si rrjedhim i politikës së punësimit të plotë gjatë viteve të kaluara të komunizmit për të dyja gjinitë. Ndonëse këto pensione nuk janë të larta, përsëri në shumicën e rasteve pensionistë të tillë mbijetojnë disi.

Dhe, si për ironi, Shqipëria është

të sot anëtare e shumë institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare si p.sh: Banka Botërore, Fondi Ndërkombëtar Monetar, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), UNICEF, PNUD, Këshilli i Europës, OSBE etj. Ndiha e huaj është përkufizuar si grante ose kredi, po ku shkojnë gjithë këto donacione? A kanë shkuar ato në rritjen e mirëqenies së këtij populli fukara? Jo!

Që nga ndryshimi i pushteteve vendi ynë ka përfituar shumë grante e ndihmë nga qeveritë e vendeve të huaja, si dhe nga institucione e organizata jofitim-prurëse të këtyre vendeve. Sigurisht, Shqipëria duke qenë një vend në zhvillim, nëpërmjet programeve dhe projekteve të ndryshme, këto vende e organizata kanë investuar shumë për të ndikuar në zhvillimin e vendit dhe zbutjen e varfërisë. A është ulur varfëria në vend apo është shtuar korrupsioni?

Të gjithë e dimë tashmë, se çfarë ka ndodhur. Varfëria duhet të mbetet shtetësisë i politikës shqiptare, sepse shkalla e varfërisë është nga më të lartat në Europë. Dhe, besoj se problemi i njerëzve të varfër dhe raportit ndërmjet tyre dhe të pasurve nuk është thjesht çështje ekonomike, apo problem teknik, që mund të zgjidhet menjëherë apo që duhet trajtuar vetëm duke hartuar plane të ndryshme veprimi në luftën kundër varfërisë. Ky problem kërkon seriozitet dhe politika strategjike afatgjata për t'i dhënë frymëmarrje vendit e

çliruar qytetarët e shumë nga varfëria e përditshme.

A ekziston një lidhje e ngushtë midis politikave të qeverisë së vendit dhe niveleve të varfërisë së tij? A është realisht kaq e rëndësishme politika që ndiqet dhe, a ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi varfërinë? Sigurisht që po! Qeveria është aktori kryesor që ka ndikimin më të madh në zbutjen e varfërisë me anë të politikave sociale. Politikat e saj ndikojnë drejtpërdrejtë si dhe tërthorazi mbi jetën e çdo qytetari të vendit sistematikisht.

Nga shifrat statistikore, gjatë vitit 2016 në Shqipëri janë shtuar dukshëm të varfrit, kurse mbi 60% e pasurisë në vend është gllabëruar vetëm nga 4% e njerëzve të pasur. Ky është një polarizim i madh që sjell çekuilibra e tensione sociale. Ky polarizim i shoqërisë shqiptare po shtur lehtë familjet dhe lidhjet e gjakut, aq bukur të strukturuar në dekada me radhë.

Prandaj, koha kërkon që të mund të rishikohen dhe të ridentifikohen roli i qeverisë, raportet e këtij ndikimi shtetëror me veprimin e tregut, sepse, siç duket, varfëria ka marrë trajta dhe forma më dinamike, të papërcaktueshme, sa që ndonjëherë, në media investigative me shtetësim kemi ndjekur "life" pamje "migracione" në disa zona të largëta të vendit tonë. Kjo na frikëson pa masë...

Brezat po ndihen çdo ditë e më të pasigurtë, ndaj dhe preferojnë të largohen nga Shqipëria, e cila po plaket nga dhimbja e varfëria në rritje.

HOROSKOPI

DASHI

Një forcë e bukur ju bën të zgjoheni euforikë dhe të guximshëm, sot që Hëna kalon te Binjakët! Ide të shpejta të ndjekura nga veprimet po aq të shpejta. Dikush do tentojë të japë urdhra, por kjo gjë nuk ju frikëson: do vazhdoni me mënyrën tuaj pa asnjë hezitim.

DEMI

E diel e qetë. Shumë gjëra të reja mund të luëzohen, nga fotografia te puna vullnetare, nga recitimi të kënga. Vetëm zemra është pak e shqetësuar...Lërimi të lirë partnerin, mos e shkëputni nga miqtë e tij. Rrini të qetë, nuk do arratiset!

BINJAKET

Nëse është e mundur, mos e merrziti veten me pyetje të kota. Me Hënë nën harmoni me Venusin dhe Neptunin, ka rrezik të bëni ndonjë gabim. Të shqetësuar nga pakënaqësitë dhe ankthi, keni tendencën të debatonit për çdo gjë me partnerin tuaj.

GAFORJA

Angazhohuni deri në fund për t'i dhënë fund një situatë konfliktive që ka shkaktuar shumë pakënaqësi në familje. Duhet të jeni të duruar me ata që ju rrethojnë, padurimi nuk ju ndihmon për asgjë.

LUANI

Sot nuk keni asnjë arsye të ndaloni aktivitetet që keni planifikuar prej kohësh. Nëse keni dëshirë të tërhiqni vëmendjen, bisedoni me miqtë tuaj. Jepni vlerën e duhur miqësisë së një personi. Tregoni besnikërinë tuaj legjendare për të fituar besimin e tij.

VIRGJERESHA

Nëse nuk jeni me humor të mirë, një pjesë e përgjegjësisë i shkon Hënës te Binjakët. Pavarësisht motivit, mos e ekzagjeroni duke humbur sensin e realitetit. Përpikuni t'i jepni zgjidhje një çështje të rëndësishme familjare që ka kohë që ju mundon.

PESHORJA

Ndjeheni optimist dhe me humor të mirë: hidhni pas kraresh problemeve e vogla dhe përpikuni të shijoni të dielën. Pranoni ndihmën e atyre që ju njohin mirë. Ndoshta komunikimi nuk është i shkëlqyer, por jo çdo gjë duhet të jetë e përkryer sot.

AKREPI

Gjërat vazhdojnë të rrotullohen. Ndoshta nuk keni zgjidhur çdo gjë në mënyrë që dëshironi, por jo pak durim dhe optimizëm do ja dilni. Faza zgjerimi. Projekte të vlefshme, zgjerim horizontesh dhe fat. Keni kartat fituese sot!

SHIGJETARI

Me keqardhje të madhe do ta kuptoni që, si kolegët, ashtu edhe partneri nuk kanë ndonjë konsideratë të madhe për ndërhyrjet tuaja vend e pa vend. Disa qëndrim nga ana e të dashurit tuaj ju shqetësojnë, ndoshta ka ardhur momenti të sqaroheni me të.

BRICJAPI

Jeni të angazhuar shumë se kurrë në punë. Nëse sot që është e dielë keni mundësi të bëni pak pushim, përpikuni të shkëputeni nga çështjet e punës! Yjet ju shtynjë të bëni më shumë për të përmbushur nevojat e partnerit të dashur.

UJORI

Një ditë dinamike e ndihmuar nga Hëna te Binjakët. Sot do ju shoqërojnë stimuj të shumtë, kurioziteti dhe lajmet e mira. Keni tendencën të përshatni dhe të vlerësoni idetë e të tjerëve: kjo gjë do ju ndihmojë shumë në profesion.

PESHQIT

Kur vjen momenti të përballeni me realitetin, gjithmonë e kuptoni se gjërat nuk janë ashtu siç duhen. Një nevrozizëm i lehtë mund t'ju nxisë të vepri, por është mirë të mos lëvizni nëse nuk e njihni dinamiken e lojës.

Opinion i Ditës

Shteti pa mirëqenie, aspak ai "që duam"

Nga Xhevat MUSTAFA

... shekull pavarësi dhe gjasmë shtet. Fjala është për premtimin apo sloganin "shteti që duam". Si gjetje dhe si formulim nuk mund të kritikohet. Në fund të fundit përbën një nga ëndrrat dhe dëshirat më të hershme e më të mëdha të shqiptarëve. Por, konceptimi, strategjia dhe realizimi konkret kanë shumë degë dhe cilat mund të kapesh lehtë e fort për të diskutuar. Të paktën, për atë që është bërë konkretisht në mandatin e parë për realizimin apo konkretizimin e këtij objekti, mund të thuhet se deri më sot jemi në fazën e një premtimi elektorale, shumë larg modelit normal dhe akoma shumë larg atij ideal, që është funksional dhe i suksesshëm në vendet më të përparuara në BE dhe në botë. Konceptimi, mentaliteti, strategjia, praktikat apo format që po zbatohen, i pakësojnë dhe zvogëlojnë arsyet, argumentet, faktet për të besuar dhe pranuar se po eчим me të vërtetë, me sineritet dhe seriozitet drejt "shtetit që duam". Shumica e shqiptarëve, që i kanë të pafshihme në kujtesë absurditetet dhe tmerrin e përjetuara gjatë 47 viteve të diktaturës komuniste, nuk mund të harrojnë se Enver Hoxha dhe Ramiz Alia krijuan dhe mbajtën fort në duar një shtet të fortë diktatorial, klanor apo personal, që të nxinte apo merrte jetën edhe për një fjalë goje, edhe për një ankesë të pëshpëritur për mungesat e shumta jetësore dhe demokratike. Në të vërtetë, ai ishte vetëm shteti i tyre dhe jo i shumicës së qytetarëve, edhe pse këta e votonin në farsat zgjedhore me rezultatet qesharake 99.99%. Nuk mund ta donin shumica e qytetarëve përderisi sa ai nuk u siguronte as demokraci, as mirëqenie dhe as jetë normale. Rezultatet konkrete apo faktet e mandatit të parë të qeverisjes nga "Rilindja" dhe personalisht nga Edi Rama, shprehin dhe përcjellin mesazhin se edhe shteti që premtojnë qeveritarët e sotëm, prej më shumë se 4 viteve, është qartësisht dhe frikshëm shteti i tyre dhe jo ai "që duam" ne si qytetarë.



Francë, Zvicër, Belgjikë, Holandë, Suedi, Itali, Greqi, SHBA, Kanada... Apo mijëra të tjerë të gjejnë alternativë mbijetese të përfshirja në rrjetet kriminale të kultivimit dhe tregimit të drogave, të prostitucionit, të shitjes së armëve, terrorizmit, vjedhjeve... Ndërsa bëhej dita-ditës ferr për shumicën e qytetarëve të thjeshtë shteti i "Rilindjes" ishte parajsë për bosët të trafikëve kriminale me shumë dosje dhe emra nëpër gjykatat dhe burgjet e botës. Jo pak prej tyre nuk e patën të vështirë të hynin edhe në preferencat apo zemrën e Edi Ramës dhe në përbërje të grupit të deputetëve të PS-së, të bëheshin kryebashkiakë, prefektë, komisarë policie, drejtorë të përgjithshëm. Për të qenë sa më konkret dhe më bindës do të rendis në vijim disa shifra apo fakte të freskëta, të publikuara jo nga "kazoni mediatiq" shqiptar, por nga burime zyrtare shqiptare e ndërkombëtare. Më 30 nëntor 2017, sipas Institutit të Statistikave (INSTAT), për vitin 2016 rezultoi se 90% e familjeve shqiptare, me 3.9 anëtarë, shpenzuan mesatarisht 63,609 lekë në muaj, saktësisht 544 lekë në ditë, ose 4 euro në ditë për frymë. Sipas të dhënave të FMN-së, Bankës Botërore dhe INSTAT-it zyrtar shqiptar, publikuar nga mediat shqiptare më 29 nëntor 2017, Shqipëria ka pagën më të ulët mesatare në Europë. Në tremujorin e parë 2017 në Shqipëri paga mesatare neto ishte 347 euro në muaj, më e ulëta në Europë, madje edhe se në Kosovë, ku aktualisht është rreth 405 euro. 38% e të moshuarve në Shqipëri jetojnë në varfëri, me ndihmë sociale dhe pensione nga 6.500-15.000 lekë, me të cilat duhet të paguajnë faturat e dritave dhe të ujit, ilaçet... Duke llogaritur çmimet e larta e në rritje për shumicën e artikujve


në Shqipëri merret me mend se çfarë u mbetet nga pensioni për të kaluar muajin...Duke qëndruar po në këtë fushë, sipas të dhënave zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, (ISSH), publikuar më 11 gusht 2017, pensioni mesatar në rang vendi ishte 11,714 lekë, ose 86 euro më 2016, kur në rajon (Serbi, Mali i Zi, Maqedoni) ishte 240 euro në fillim të 2012, shifër kjo 2.5 herë më e lartë se e Shqipërisë. Kuptohet se standardet e BE-së duken të pakapshme nga ne. Më 14 dhjetor 2016, po sipas "Eurostat"-it, Shqipëria ishte vendi i dytë më i varfër në Europë, me të ardhura për frymë rreth 30 për qind e mesatares së vendeve të Bashkimit Europian. Në vitin 2015, nivel më të ulët mirëqenieje sesa ne kishte vetëm Bosnja, ku të ardhurat ishin sa 28 për qind e mesatares së BE-së. Ndërsa vendi zhytje në një krizë të thellë ekonomike dhe rritje të papunësisë, shprehur edhe në rritjen e ushtrisë së të varfërve, ndërsa pritej që të kishte shtet social më human e më të ndjeshëm, qeverisja e majtë ka shkurtuar në mënyrë drastike numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike. Sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT, në vitin 2013, qeveria jepte ndihmë ekonomike për gati 102 mijë familje në shkallë vendi. Por në tremujorin e dytë të vitit 2017 janë vetëm 72 mijë familje që asistohen me ndihmë ekonomike, duke u hequr nga skema mbi 30 mijë familje të varfra. Për paradoks apo mosfshetje të pandjeshmërisë sociale gjatë viteve të fundit u janë dhuruar qindra milionë euro në vit nga paratë publike, nga buxheti i shtetit, bizneseve të mëdha dhe koncesionarëve. Ndërkohë që të varfrit sakrifkohen për të ruajtur deficitin janë shpenzuar qindra milionë euro për fasada, palma, beton, pllaka, mobilim të zyrave të adminis-

tratat...

Të dhënat e mësipërme i kundërshtojnë fort mburrjet e qeveritarëve dhe politikanëve të "Rilindjes" për "rritje ekonomike" dhe shprehin thellim, masivizim apo lakurijësim të pandaishëm të varfërisë. Format e saj i shikon kudo dhe vazhdimisht. I shikon dhe kupton te shtimi i fytyrave të reja që gërmojnë në kazanët e plehrave: i lypsava, peshëmatësve, shitësve të misrave dhe gështenjave, të veshjeve dhe librave të përdorur nëpër trotuare; të dyqanet e bizneseve të vegjël dhe të mesëm, ku shitëset harxhojnë më shumë me celularët se sa me blerës...I shikon nëpër kafene, ku njerëzit shtyjnë ditën me një filxhan kafe 50-70 lekë dhe me lajmet, fjalëkryqet dhe bastet sportive të gazetave; nëpër rrugë ku shikon shtim të njerëzve që flasin me veten, që po agresivizohen dhe çmendin nga mijëra hallet e përditshme të mbijetesës...I shikon dhe ndien në shumë shtëpi e familje, në sherrat e dhunshme mes bashkëshortëve dhe prindër-fëmijë; në shtimin frikshëm dhe alarmues të shifrave të kriminalitetit, prostitucionit, divorcit; të vjedhjeve të objekteve tregtare, bankare, të banesave qytetare; të përdoruesve të drogave, alkoolit, lojërave të fatit...I kupton edhe nga rritja e numrit të vetëvrasjeve...Varfërimi u pa dhe kuptua edhe në Panairin e Librit më 15-19 nëntor 2017, ku me shumë gjasa i në 10 vizitorët guxoi të blinte libra, duke i nxjerrë jo pak botues me humbje, për shkak edhe të fatursë së lartë për një metër katror vend. Format dhe përmasat e varfërimit u vunë re edhe në Panairin e Agrobiznesit "Shqipëria punon tokën", më 29 nëntor 2017, ku kishte më shumë shitës se sa blerës, me shumë gjasa duke mos u kompensuar tregtarëve as shpenzimet e transportit dhe të

vendit të zënë në sheshin "Nënë Tereza". Në këto kushte, në mijëra familje të përmbytura nga varfëria, që nuk u ndahet nga lindja në vdekje, mund të gesh jo pak fëmijë që mallkojnë prindërit përse i lindën dhe prindër që mallkojnë njeri-tjetrin, po për të njëjtën arsye. Pas këtyre të dhënave apo pas kësaj panorame varfërie masive, mund të rishtrahet pyetja: Në këto kushte dhe në këtë realitet mund të jetë "shteti që duam" ky lloj apo biçim shteti që na premtin "Rilindja" dhe Edi Rama? Të mos arrihet për 105 vjet të krijohet shtet i vërtetë ligjor, demokratik dhe funksional; me industri, bujqësi dhe ekonomi moderne, të fuqishme dhe konkurruese në rajon e përtej tij; me mirëqenie të lartë në një vend me pasuri të mëdha nën e mbi tokë; me resurse të mëdha për turizëm gjithëvjeter, shpreh apo nënkupton shumë. Duke kërkuar arsyet mund të arrihet deri në përfundimin se më shumë se mosdije dhe paafësi, mund të ketë mosdashje dhe papërgjegjshmëri, deri në caqet e tradhtisë, për t'i djegur mendje dhe duar shqiptare këto pasuri kombëtare natyrore, këto shanse e mundësi apo për të mos i shfrytëzuar në dobi dhe interes të zhvillimit, përparimit dhe fuqizimit të vendit dhe të rritjes së ndjeshme e të vazhdueshme të mirëqenies së qytetarëve. Edi Rama mund të mbrohet dhe justifikohet se në strategjinë e tij është përparësor "shteti ligjor", vetinguj gjërëpërshirës. Por, kjo nuk e përjashton dyshimin dhe frikën se shtetin social, të mirëqenies së mesatare, ai mund ta ketë planifikuar apo shtyrë për në "kalendër grekë". Përvoja pozitive e Zvicrës, Suedisë, Danimarkës, Norvegjisë, Finlandës, Islandës, Kanadasë, Australisë, Zelandës së Re, etj, etj., tregon se shteti ligjor demokratik dhe ekonomia moderne, e fuqishme dhe konkurruese në botë e rrjedhimisht mirëqenia e lartë, mund të arrihen edhe paralelisht. Gjithashtu, mund të merret në konsideratë se punësimi masiv, pagat dhe pensionet e larta, mirëqenia e lartë sjellin ndërgjegjësim të qytetarëve për t'i respektuar dhe zbatuar ligjet e rregullat, detyrimet dhe përgjegjësitë, sjellin njëkohësisht ulje të kriminalitetit shumëfëmish, të korrupsionit, informalitetit...Në të kundërt, përvoja e disa vendeve të Amerikës Qendrore dhe asaj Latine, e Filipinëve, Tajlandës, Afganistanit, Turqisë, etj., ka treguar se qeverisjet dhe shtetet e ndërtuara mbi themelet e kultivimit të gjërë dhe tregtisë së drogave; të ortakllëkut me bosët e krimin dhe të trafikëve të paligjshme; të industrisë së pastrimit të parave apo edhe të parajsave fiskale; nuk sigurojnë as zhvillim modern e të qëndrueshëm, as ekonomi të fuqishme dhe konkurruese, as mirëqenie të lartë, as shtet ligjor dhe demokratik të vërtetë.

Fjalëkryqi (1)




HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzja.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një dite në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimm.
23. Pak elementare.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.
37. Janë legjendat.
38. Nuk ka akoma një bebe.

VERTIKAL

1. Kanë shpate të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla.
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve.
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë sifitë e... provimeeve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa gift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëshiellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litrar.
46. Fillojnë tejen.

Fjalëkryqi (2)




HORIZONTAL

1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë ilustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shklop, thupër.
37. Eshhtë Shqipëria e madhe.


VERTIKAL

1. I famshëm ai i Sifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërrajore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hidhen të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllen me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullmann aktore.
43. Një brilantinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

F-JALËKRYQI (1)

F-JALËKRYQI (2)

Argëtim filozofik



SUDOKU

6		4		1		3		2
	7						5	
	8		5		4		9	
8				5				7
			9		1			
7				3				6
	1		2		3		6	
	3						7	
4		5		9		2		8

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	3	9	7	4	5	2	1	6
5	2	1	9	3	6	4	8	7
4	6	7	8	1	2	3	5	9
7	8	6	5	9	4	1	3	2
3	9	5	2	8	1	7	6	4
1	4	2	3	6	7	8	9	5
6	5	8	4	2	3	9	7	1
9	7	4	1	5	8	6	2	3
2	1	3	6	7	9	5	4	8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

MJESHTRI MAGJIK, DA VINÇI

- Kam vënë re se njerëzit rrallë përipiqen të arrijnë diçka. Ata më tepër rehatohen dhe i lënë gjërat t'u ndodhin. Në fakt, ata i dolën përpara rastësisë dhe u ndodhën të gjërë.
- Arti nuk mbaron kurrë, vetëm braktiset.
- Lotët vijnë nga zemra dhe jo nga truri.
- Ku ka të bërtitura, nuk ka dije të vërtetë.

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

K	U	L	T		14	4		9		7	4	19
8	10	5		1	4	12	2	6	7	5		10
10	4	7		4	1	2	8	10	6	4	7	5
18				1	7	5	8	9	4	2	10	4
6	5	1		6	2	10	5	2	5			12
7	1		17	5		1	5	10	17	4	2	
2	5	10	17	4	2		4	10	6	15	5	
8		2	8	12		15		6	10	17	5	
18	10	5	16	19		6		4	8		10	1
6		7	5		6	11	5		9	19	6	7
4	11	4	7	6	2	0	1	5		7	17	6
12	5	2	5		12	1	6	15	4	2		8

K	A	F	E		T	A	L	E	N	T					
A	D	A	M		P	A	F		T	E	R				
T	E	T			H	E	P	A	T	I	T	I			
E	T				H	E	R	E	T	I	K	E			
G					K	O	M	I	T	E	T	E			
O					E	K	I	P	E	T		F			
R	I				K	N	E	T		T	A	P			
I					O	G	C			S	T	I	L		
K	P				S	W	I	N	G			S	L		
E	O				P	A	T	E	N	T	A	T			
N	A				Y	E				U	R	A	T		
T	Y				M	I				P	I	R	A	T	I

Thënie të mençura

- Gëlltite zemërimin, sepse, sa i përket përfundimit, nuk ka asgjë më të ëmbël dhe më të lehtëzshëm sesa ky veprim.
- Kur ti je i suksesshëm dashamirët e tu të vërtetë e dinë se kush je, por kur je i pasuksesshëm ti din cilët janë dashamirët e tu.
- Një njeri s'mund të ndihet realisht mirë, në rast se nuk aprovon vetveten.
- Bota është një anije mbi të cilën jemi të gjithë pasagjerë: nuk duhet të lejojmë që ajo të mbytet. (Mikhail Gorbacov)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

